



PRANUAR MË:  
ACCEPTED ON: 08.11.2022  
PRIMLJENO:  
Nr.No.Bt. 02/542

REPUBLICA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Nr. 02/  
Datë: 08.11.2022

**PROCESVERBAL**

i mbledhjes së -VI- (gjashtë) të rregullt Kuvendit Komunal të Malishevë

**R E N D I D I T Ë S**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -III- (tretë) të jashtëzakonshme datë: 13.05.2022 dhe procesverbali nga mbledhja e -V- (pestë) të rregullt datë: 09.08.2022
2. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë së Bujqësisë përfundimin e korrijeve-shirjeve, për vitin 2022.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1608 datë:19.09.2022, për ridestinimin e mjeteve nga projektet kapitale.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/831 datë: 31.08.2022 për projekt-buxhetin për vitin 2023-2025, me theks të veqant për vitin 2023.
5. Shqyrtimi i kërkesës nr. 02/252 datë: 23.05.2022 të parashtruar nga Besnik Bytyqi, për lejimin e ndërtimit të rrethojave të varrezave në fshatin Shkozë.
6. Shqyrtimi i kërkesës nr. 11/651 datë13.09.2022 e parashtruar nga Drejtoria për arsim dhe Edukim,për Komisionin përzgjedhës për shqyrtimin e konkursit për zgjedhjen e drejtorit dhe të zëvendësdrejtorit në institucionet arsimore, që janë në vartësi të Komunës,sipas konkursit nr.11/1418 datë:12.08.2022,nr.11/1419 datë: 12.08.2022.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/394 datë: 13.09.2022 e parashtruar nga Zyrafete Paqarizi nga fshati Dragobil.
8. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 27.09.2022 dhe filloi në ora: 10:20. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 29 asambleistë, kryetari, nënkyetari, drejtorë komunal,përfaqësues nga OSBE-ja, përfaqësues nga KFORI Zvicëran dhe zyra për informim. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Malishevës z.Argjend Thaçi.

**Argjend Thaçi:** Përshëndetje për të gjithë dhe mirë se keni ardhur në mbledhjen e gjashtë të rregullt të kuvendit komunal. A e dëshironi fjalën jashtë rendit të ditës.Urdhëro, Mirëlinda!

**Mirëlinda Gashi:** Përshëndetje për të gjithë!

Unë dua ta nGRE një çështje pËR Drejtoren e Shërbimeve Publike rrëth transportit urban, sepse nuk po ka vija të mjaftueshme pËR transport të udhëtarëve. Unë kërkoi nga Drejtoria pËR Shërbime Publike që tË del tË shikojë gjendjen dhe tË vendos më shumë vija tË transportit pËR udhëtarët.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit, Mirëlinda!  
Urdhëro, Arlind!

**Arlind Morina:** Përshëndetje për të gjithë !

E falenderoj Drejtoren e Administratës pËR punën e mrekullueshme që e ka bëre qëna ka pajisur me llaptop.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit, Arlind!  
Urdhëro,Veton!

**Veton Zogaj:** Përshëndetje për të gjithë!

Prej 6 seancave që i kemi mbajtur kam pasur 33 qështje që i kam shprehur këtu dHE vetëm një nga ato 33 qështje është realizuar dHE ajo është kërkesa pËR rrugën "Adem Jashari" që është asfaltuar. Sot i kam dHE 5 qështje tË tjera, e para ka tË bëjë me Drejtorenë e Urbanizmit. Kemi shumë rrugë nË fshatra tË cilat nuk janë bërë, janë dëmtuar, gropë ka gjithandej dHE ne ndajm buxhet vjetor pËR mirëmbajtjen e rrugëve dherrugët që sa vite i kemi tË njëjta. Te trotuarët janë dy raste tË cilat i kam parë vet, është rasti i trotuarit nË lagjen "Hazrolli" nË Banjë, ai trotuar nuk e plotëson asnjë kriter, është 40cm dHE nuk e di se si do tË eci një njeri nË atë trotuar. I njejti rast është trotuari nË rrugën "Adem Jashari" te Tërpëza e ulët. Trotuari te lagjia "Haxhaj" nË Carrallukë, janë 15m që nuk është shtruar trotuari pËR arsyen politike. Qështja tjetër është keqpërdorimi i veturave zyrtare. Unë kam bëre pytje dHE nË seancën e kaluar dHE dëshiroj tË di se kush ka tË drejtë me i përdor vetrat zyrtare pas orari tË punës? Unë e kam parë që Drejtori i Shëndetësis po e përdor vetrën zyrtare pËR nevoja personale dHE jo pËR punë. Qështja tjetërështë një urë e vogël te Delfina dHE stacioni i autobusëve, që nuk ka një rrithojë që t'i mbrojë qytetarët kur tË kalojnë sepse është shumë rrezik pËR ta. Qështja e kontratës me TV Diellin, pËR promovimin e qeverisjes pËR projekte tË caktuara, a nuk kemi ne mediume lokale që nuk ja kemi dhënë këtë kontrat. I kemi dy media lokale është dashur paraprakisht tË ftohendhe tË bisedohet dHE ndoshta na i kishin mbuluar këto promovime dHE këtë qështje mediale pa para.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valjetë!

**Valjetë Hoti:** Përshëndetje pËR të gjithë!

Një pytje pËR ekzekutivin apo ata që e ndiejn vetën kompetent pËR këtë qështje: Çfarë ka ndodhur me bursat e studentëve? Nëse keni vendosur me i ndalu tË dilet me një arsyetim serioz dHE tË tregohet arsyaja pËRse mjetet tË caktuara pËR këtë qëllim kanë shkuar nË projekte tË tjera?

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Alban!

**Alban Kastrati:** Përshëndetje për të gjithë!

Unë dëshirova të ngris një qështje që kohët e fundit jemi ballafaquar të gjithë. Këto ditë kemi pasur ndërprerje të rrymës me orar të gjatë, afér 24 orë pa rrymë. Unë kam provuar që të kontaktojë me menaxherët e KEDS-it, por nuk kam mundur të marr ndonjë informatë. Unë po kërkoj nga ju që ta bëni një linjë komunikimi në mes qytetarëve dhe KEDS-it, ose t'i bëhet presion KEDS-it që mos me u sjellë kështu me qytetarët e Malishevës, sepse forma që është duke u sjellur KEDS-I është duke i injoruar qytetarët.

Dua ta falenderoj Drejtorin e Administratës dhe Kryesuesin për pajisjen me llaptop, na keni ofruar kushte më të mira dhe tanë neve na mbetet vetëm të punojm.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit, Alban urojë t'i gjëzoni. Urdhëro, Halil!

**Halil Morina:** Përshëndetje për të gjithë!

Shfrytëzojë rastin të falenderoj drejtorin dhe qeverinë komunale për furnizimin me llaptop, të cilët do na lehtësojn punën si anëtarë të kuvendit komunal. Një prej detyrave më të rëndësishme për ne si asambleistë është që të shprehim shqetësimet për qështje të ndryshme sa i përket Komunës tonë. Siç tha dhe Albani duhet të ketë një linjë në mes KEDS-it dhe qytetarëve për shkak të problematikave dhe ndaljes së rrymës në mënyrë arbitrale, por mundet me pas dhe dezinformata. Unë nuk mundem me dal me dhënë vlersime rreth infrastrukturës, sepse duhet me qenë eksapert i asaj punës dhe duhet me pas një liqenc prej autoriteteteve të caktuara që je në gjendje me e vlersu një kanalizim, një trotuar dhe me thënë sipas ekspertizave të mia kjo nuk i plotëson standartet fare. Sa i përket Drejtorit të Shëndetësisë të gjithë e dinë se qfar pune ka bërë Drejtori Hajdin Berisha. Gjatë kohës së pandemis ka marr vlerësimë dhe nga oponentët e tij politik për këtë qështje dhe me dal me thënë që vetëm me shëndetësi nuk merret, këtë nuk ta pranojnë as votuesit e tu. Andaj ta përdorim këtë foltore për shqetësimë të cilat janë në dobi të qytetarëve të komunës.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon!

**Valon Mazreku:** Përshëndetje për të gjithë!

Faleminderit kryetar dhe drejtor për llaptopët që na keni sjellë.

Unë kam dy shqetësimë: kërkesa e parë ka të bëjë me qytetin e Malishevës. Programi I Nisma Socialdemokrate e cila i ka fituar zgjedhjet ka qenë Malisheva Urbane dhe orientimet që kanë ardhur në projekt buxhetin janë të mbështetura në programin të cilin e ceka. Ajo që ne si qytet I kemi mangu dhe konsideroj që është koha me vendos për këtë qështje, është qështja e varrezave të qytetit. Ne ende nuk kemi një lokacion të caktuar për varrezat e qytetit, duke e marr parasysh trendin e migrimit nga fshatrat në qytet, trendin e ndërtimit të objekteve në qytet është e domosdoshme që sa më parë të përcaktohet një pronë për varrezat e qytetit.

Kërkesa e dytë është që ndoshta shumë komuna kanë këtë problem, i cili është problemi me qentë endacak, ky është një fenomen që po na shqetëson të gjithë. Kisha kërkuar që sa më shpejt të bëhet një zgjidhje për këta qenë endacak, sepse jemi të kërcënuar të gjithë jo vetëm fëmijët.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Burim!

**Burim Paqarizi:** Përshëndetje për të gjithë!

Unë sot do e ngis një çështje. Ne e kemi parë që orientimi i buxhetit është në qendër të qytetit, por shqetësim kryesor i qytetarëve është çka ka me ndodhë me qendrën dhe ne ende nuk kemi parë asnjë projekt se si ka me u realizuar qendra e qytetit. Kemi pyetje se si do të duket, çka do të përbajë?

Ne kemi parë që tenderi është fituar nga një kompani e qytetit, është mirë që në ditët në vazhdim të prezantohet projekti çka do të përbajë, si do të realizohen ato parkingje nëntoksore, por me 2.000.000.00E mundet me u ndërtu vetëm një parking mbitokësor, jo ai nëntokso. Kryetari ndoshta mundet me na shpjegu këtë më mirë. Një shqetësim tjetër i qytetarëve është lokalet që gjenden në rrugën "Ibrahim Mazreku", çka do të ndodhë me ato lokale, a do të shkatërrohen apo si është gjendja e këtyre lokaleve. Të na jepet një shpjegim më të mirë, sepse ju rrezikohen bizneset që i mbajnë familjet e tyre.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Veton!

**Veton Zogaj:** Kryesues, merre rregulloren dhe shpérndaju asambleistëve që ta lexojnë dhe ta respektoni rregulloren kush ta kérkon fjalën i pari për replik duhet me ja dhënë. Halil, vetëm ligjérata psikolgjike mos na mbajë. E dimë ne qfarë ideologjije të politikës ndjekim, qfarë eksperti të duhet kur të tregojmë që rrugët janë të ndërprera nëse dëshironi shkojmë të gjithë dhe i shkojmë në qfar gjendje janë ato rrugë. Qfarë eksperti po kérkon me ta vlersu trotuarin kur në kontrat shënon 80cm gjersi, por në ato trotuare nuk janë 80cm. Qfarë eksperti po kérkon që kjo përrocka te stacioni i autobusëve është në gjendje të tmerrshme prej kanalizimeve dhe nuk ka mur mbrojtës.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Alban Kastrati!

**Alban Kastrati:** Është mirë që në seancat e tjera të jeni prezent në mënyrë që të ju përgjigjeni pyetjeve tonë. E kam parë në media që të shtunën Kryeministri i ka thirrur të gjithë Kryetarët e çdo komune një takim me ta. Kryetar a keni pasur takim me Kryeministrin dhe a i keni propozu ndonjë kërkesë Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe a keni pasur ndonjë përgjigjje nga ai.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro Halil Morina!

**Halil Morina:** Ka segmente të caktuara ku në disa vende kur ska pasur më shumë pronë publike është dashur të ngushtohet trotuari, për këtë arsyе t'i kursejm dezinformatat.

**Argjend Thaçi:** Fjalën e ka kérku Nebih Bibaj!

**Nebih Bibaj:** Halil, ne kemi të drejt të bëjmë pyetje dhe janë personat kompetent që minden me na dhënë përgjigje është Kryetari dhe janë Drejtorat.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Labinot!

**Labinot Gashi:** Përshëndetje për të gjithë!

Problemet që u ngritën nga kolegët ekzistojnë, mirëpo unë desha ta ceki një qështje meqenëse jemi në javën e pestë të grevës, në grevë është dhe administrata komunale në gjithë Kosovën. Një

konkurs që është hapur për Drejtor të shkollave, qytetarët kanë pasur probleme që të aplikojnë dhe konkursi ka përfundu dje, deshta një përgjigje nga Drejtoresha e Arsimit dhe kisha kërkuar që afati i aplikimit të shtyhet.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Kryetar!

**Ekrem Kastrati:** Përshëndetje për të gjithë!

Sa i përket varrezave të qytetit, ne jemi përcaktu në një lokacion te salla e sportit, mirëpo kemi bërë një kërkës që të ndahet dhe një parcelëpër shoqatën Jetimat e Ballkanit kërkës që dhe ju e keni miratuar, një institucion përfshirë me nevoja të veqanta. Po vazhdojnë përpjekjet me përfaqësuesit e Jetimave të Ballkanit që me e jetës u këtë projekt i cili është i vetmi në Kosovë dhe këtë po mundohemi që me e sjell në Malishevë. Për qenët endacak është një problem e kemi theksuar dhe më parë që nuk është vetëm komuna Malishevës që ka këtë problem por është e tërë Kosova. Komuna e Prishtinës ka filluar trajtimin por po ka shumë vrejtje, sepse kanë fillur që nga komunat tjera të dërgohen qenët endacak në Komunën e Prishtinës dhe po ka probleme. Ne përvitin 2023 do ta parashohim një buxhet minimal në përputhje me mundësit tona dhe do të tentojmë të kemi një bashkëpunim dhe me komunën e Klinës dhe të i trajtojmë këta qenët endacak. Për qentë endacak është biseduar dhe në takim me Kryeministrin dhe është zotuar që kanë me e trajtu këtë qështje besoj që do të dal me një udhëzim administrativ apo me një akt ligjor që e rregullon këtë qështje.

Te qendra e qytetit sigurisht që keni të drejt të gjithë të pyesni se qfar do të bëhet me qendrën e qytetit. Ne sigurisht i kemi marr disa hapa dhe kemi shpallur një thirrje publike që të aplikojnë kompanitë e interesuara dhe tashmë kanë aplikuar disa kompani. Në momentin kur të nënshkruhet kontrata ju do të jeni të parët që do ta shikoni projektin që do të vijë dhe eksperti së bashku me qeveritë komunale dhe së bashku do ta prezantojmë këtë projekt.

Takimi me Kryeministrin është e vërtet ne kemi pasur takim të shtunën dhe kemi biseduar për shumë qështje. Kanë qenë 3 tema: energjia elektrike, ujrat, shpenzimet kapitale, buxheti përvitin 2023. Ndërsa për shqetësimet e juaja i kam ngritur 3 tema: e para ka qenë uji i pijes, kam kërkuar që tëna ndihmojë lidhur me projektin e ujësjellsit përmes sistemit të Radoniqit. Tema e dytështë furnizimi me energji elektrike, Malisheva gjithmonë ka redukttime përsyrë të sistemit të ngusht qëna vjen nga Rahoveci prej 35kë dhe deri të vjen te ne bëhet 20kë, sepse ka humbje dhe detyrimisht ne duhet me pas redukttime. Kërkova nga kryeministri që dhe në këtë qështje të marr masa tëna ndihmoj të inicioj procedurën që ka qenë më heret përvimin e 220këdhe tani vetëm presim vendimin nga qeveria. Kërkesa ime e tretë ka qenë ndërtimi i fabrikës së ujrate të zeza në Bubël, sepse ju e dini që lumi mirusha e ka një kontaminim nga ujrate zeza që derdhen në lum, dhe na duhet sa më shpejt me ndërtu një fabrik të tillë në mënyr që lumi mirusha ta ketë një cilësi të mirë të ujtit të jetë aset racional jo vetëm për Malishevë por për krejt Kosovën. Këto ishin temat që i kam ngritur në takim me Kryeministrin.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Avdi!

**Avdi Morina:** Përshëndetje për të gjithë!

Këto vonesa që janë bërë përmirësuarjan e rrugëve janë bërë për shkak të vonimit të alokimit të buxhetit, pastaj organi shqyrtues i prokurimit publik nuk ka qenë funksional. Ankesat që kanë qenë në këtë organ nuk i ka shqyrtuar deri më tani, sot oragni i prokurorimit i ka kthyer përgjigjet konform vendimit që ka nxjerr Komuna e Malishevës dhe pikërisht sot nënshkruhet

kontrata e mirëmbajtjes së rrugëve, e cila është me kontrat tre vjeqare. Tek trotuarët që i ceke për ngushticat ka disa prona që janë private dhe njerëzit nuk dëshirojnë që të vendosin trotuar në pronën e tyre dhe kemi qenë të detyruar që në disa vende të i ngushtojmë ato trotuare. Qështja e prrockës mund të jetë problem dhe unë pajtohem plotësisht, por mënyra e qasjes tënde më shumë është tendencioz sesa zgjidhje problemi.

Te bizneset në momentin që nënshkruhet kontrata do të dalim dhe do ta paraqesim projektin para bizneseve, sepse i prek një numër të konsiderushëm të bizneseve.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Labinot!

**Labinot Gashi:** Unë e ngrita qështjen e konkursit për Drejtor të shkollave që është mbyllur konkursi dhe qytetarët kanë pasur problem të aplikojnë, a ka mundësi që konkursi të shtyhet për shkak të grevës. Përgjigjjen ndoshta mundet me na dhënë dhe Kryetari i Komunës, sepse është shqetësim i qytetarëve.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro drejtor!

**Fatmir Ademaj:** Çështja e grevës është në të gjitha institucionet e kuveneve Komunale në Republikën e Kosovës, por ne si Drejtori e Administratës kemi krijuar një linjë emergjence ku kanë punuar dhe ofiqarët. Sa i përket konkursit nuk jam kompetent për të, por për pranim të dokumenteve kompetent jemi ne Drejtoria e Administratës nuk ka asnjë qytetatrë që ka sjellur dokumentacion dhe që nuk i janë pranuar për aplikim.

**Argjend Thaçi:** Drejtoresha e Arsimit Arbëresha Krasniqi e ka fjalën.

**Arbëresha Krasniqi:** Përvendetje të gjithë!

Unë I dëgjoja pyetjet të cilat i bëte për konkursin për drejtor, i cili tashmë është i mbyllur ligjërisht, dhe nuk kemi të drejt që konkursi të vazhdohet, sepse janë procedurat e tjera, dhe unë personalisht nuk kam dëgjuar që ndonjë qytetarë ka ardhur që të aplikoj dhe nuk ka mundur që të aplikoj për shkak të grevës. Unë i falenderoj të gjithë punonjësit e Administratës në komunën e Malishevës që secili me përkushtim i ka kryer të gjitha punët edhe pse sipas sindikatës dhe sipas tyre janë në grevë. Qështja e bursave në bashkëpunim me kryetarin e komunës jemi duke e trajtuar jo tanë por ka shumë kohë që t'i përfshijmë të gjithë aplikuesit për bursë. Pra kërkesa e DKA-së është që të plotësohen të gjitha kërkuesat për bursë dhe jo vetëm ato që janë parapar, besoj që shumë shpejtë do të kenë mundësi t'i gëzojnë bursat të gjithë ata që kanë aplikuar, normalisht ata të cilët i plotësojnë kushtet e kriteret që janë në konkurs.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro Mirëlinda Gashi!

**Mirëlinda Gashi:** Unë më heret e bëra një pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike, mirëpo ai për momentin nuk është këtu nëse Kryetari mundet mem dhënë përgjigje për transportin, unë bëjë kërkës që të shtohet linja e autobusave sepse shumë pak ka linja transporti po ashtu kur të fillon shkolla autobusët po janë shumë të mbi ngarkuar me një numër të madhë të nxënësve të cilët rri në këmbë. Unë kërkoj dhe nga policia që të dal dhe të shohin gjendjen se qfarë po ndodhë.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Nënkyetar!

**Vesel Krasniqi:** Përshëndetje të gjithë!

Sapo ka përfunduar konkursi për aplikim për ndarjen e vijave nëpër fshatra. Ka fshatra që ne i kemi shpallur për linja por kompanitë nuk kanë shprehur interes dhe nuk kanë aplikuar për ato fshatra, ne do të interesohemi sepse është interes i të gjithë qytetarëve për me pas linja më të shpeshta nëse jo autobus sigurisht do të angazhojmë kombibusa në mënyrë që qytetarët të mund të ken linja të caktuara për lëvizje të tyre. E cekë që ka autobusa të mbingarkuar por unë kam vrejtur dhe vetë që ka autobusa që me 5 nx.e mban linjën, por sigurisht do t'i inspektojmë këto qështje të cilat janë shqetësim.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit nga të gjithë ju që kontribuat në diskutimin jashtë rendit të ditës. Kalojmë tek rendi i ditës, fillimisht kërkoj të hyjë në rend të ditës një pikë e cila ka të bëjë me një rishqyrtim të ligjshmëris të aktit, arsyetimi që e ka kthyer ministria është: Ministria e mjedisit, planifikimit hapsinor dhe i infrastrukturës pas shqyrtimit të përbaltjes të vendimit nr.02/367 për miratimin e kërkesës nr.02/190 datë: 15.04.2022 të parashtruar nga kryesia e fshatit Bellanicë për bashkimin, ndarjen e parcelave dhe caktimin e lokacionit të ri për varrezat në fshatin Bellanicë, miratuar nga Kuvendi në Malishevë, konstatoj që hyrja e vendimit duhet të jetë sipas ligjit nr.04/L-174 për planifikimin hapsinor. Vendimi duhet të jetë i bazuar në dokumentet e planifikimit hapsinor sipas Ligjit nr.04/L-174 për planifikimin hapsinor dhe dokumenteve të tjera që janë të parapara me këtë Ligj. Nuk lejohet destinim tjetër apo shfrytëzim tjetër nga ajo që është e parapar me dokumentet e planifikimit hapisnor pjesën tekstuale dhe grafike në fuqi sipas Ligjit 04/L-174 për planifikimin hapsinor. Të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm konform dispozitave ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i parapar me dispozitat e nenit 9 të rregullores nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave. Kërkoj nga ju që kjo pikë të hyjë në rend të ditës. Urdhëro, Nebih!

**Nebih Bibaj:** Përshëndetje për të gjithë!

Ne si grup i PDK-së, kërkojmë largimin nga rendi i ditës të projekt buxhetit për vitin 2023-2025, me arsyeshmërinë se ne si grup parlamentar besojm se ky projekt buxhet nuk i ka kaluar të gjitha procedurat e mundshme, duke filluar prej dëgjimeve publike nëpër fshatra që i keni ikur realitetet me u ballafaquar me qytetarin. Në muajin mars të këti viti ka qenë një fjalë publike e kryetarit që ju si opozitë dojeni të përfshirë në projekt buxhetin e vitit të ardhshëm, dojeni të thirrur që ta bëjmë një projekt buxhet për komunën, por jo në këtë formë të një anshme të cilën keni shkuar. Kryetar, më ka shqetësuar fakti që nuk ke bërë dëgjime publike nëpër fshatra. Ne jemi për të investuar në qendër, mirëpo ku keni qenëdy mandatet tjera pse nuk keni investuar. Ne si opozit kemi qenë të gatshëm të jemi brenda buxhetit. Çka do t'i bëjmë ne atyre që kanë mbetur pa kanalizim e pa trotuar, ky është një fakt që mua më shqetëson. Na ka ardhur prapë një fletë për projekt buxhet, janë hequr disa mijete dikun dhe i ke shtuar në një vend tjetër, kjo për herë të parë ndodhë. Kjo po më shqetëson që keni obligime shtesë dhe po na sjellni këto në Kuvend. Ne jemi që kjo pikë të largohet dhe të ulemi bashkarisht ta bëjmë buxhetin. Të paktën shefat e grupit të thirren dhe të ulen të bisedojnë.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon!

**Valon Krasniqi:** Përshëndetje për të gjithë!

Unë propozoj që të futet në rend të ditës zëvendësimi i antarit të Komisionit të Bujqësisë nga radhët e VV-së dhe Listës Guxo, arsyja është që antari i deritanishëm ka marrë përgjegjësi të reja në një subjekt tjetër politikë.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Labinot!

**Labinot Gashi:** Përshëndetje për të gjithë!

Sot kemi për t'i diskutuar çështjet më të rëndësishme për qytetarët e Komunës së Malishevës. Me 1 shtator kryetari e ka për obligim të ja dërzon Kuvendit buxhetin. Kuvendi i bënë dëgjimet publike. Një shqetësim tjetër sa i përket buxhetit është se në në fillim të senacës na erdhi një material, i cili ka komplet ndryshim të shifrave me atë që e kemi marrur në email. Na duhet hapsirë dhe kohë që dhe ne të japim propozime. Deri me 30 shtator është afati i fundit i kalimit të buxhetit dhe kisha kërkuar të na jepni kohë dhe të sjellim dhe ne ndonjë propozim. Në këtë legjislaturë Kuvendi është i degradun, sepse Kryesuesi është përfaqësues i Kuvendit dhe jo i neverisë. Ne po dëshirojmë të japim kontribut dhe ju po na e pamundësoni.

**Argjend Thaçi:** Ky Kuvend dhe kjo legjislatur është më e mira prej të gjitha legjislaturave të kaluara. Pse nuk kalon një projekt ose një qëllim nuk do të thotë me degraduar Kuvendi. Urdhëro, Veton!

**Veton Zogaj:** Përshëndetje për të gjithë!

Dhe unë po e ndaj kërkësen e njejtë me dy përfaqësuesit e partisë opozitare. Arsyja pse po kërkojmë që pika për buxhetin të shtyhet për një seancë tjetër është sepse nuk janë respektuar disa prej procedurave ligjore të cilat keni qenë si qeveri komunale të obliguar. Ligji përmenaxhimin e financave na obligon neve qoftë si kuvend apo si kryesi të kuvendit, si KPF-ë që t' i mbajmë dëgjimet publike. Kemi qenë të obliguar të dalim të i mbajmë në disa bashkësi lokale disa dëgjime publike, ajo që e kam parë unë nga nënshkrimet e dëgjimeve publike, janë të gjithë punëtorë të administratës që kanë marrë pjesë në dëgjime publike. Nuk ka asnje kriter për barazin gjinore.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Halil,!

**Halil Morina:** Pika e projekt buxhetit nuk ka asnje shkelje ligjore, ndëgjimet publike janë mbajtur, është mbajtur dhe me kryetarë të fshatrave kështu që ne si grup parlamentar jemi pro e këti rendi të ditës duke e pasur parasysh dhe propozimin që ka ardhur nga MAPL-ja ajo pikë patjetër që duhet të hyjnë në rend të ditës, duke pasur parasysh dhe propozimin tënd.

**Argjend Thaçi:** 29 asambleistë janë prezent. E hedhim në votim propozimin tim së pari: Shfuqizimi i vendimit nr.02/367. Kush është që ky propozim të hyjë si pike në rend të ditës? Me vota unanim, ky propozim hynë në rend të ditës. Kalojmëte propozimi i Nebih Bibaj nga PDK-ja që pika shqyrtimi dhe miratimi i projekt buxhetit përvitin 2023-2025 të largohet. Kush është për?

Për: 14

Kundër: 15

Abstenim: 1

Me 14 vota për, 15 kundër dhe 1 abstenim kjo pikë mbetet në rend të ditës.

Kalojmë tek propozimi I Valonit: Zëvendësimi i antarit të VV-së në Komitetin për Bujqësi. Kush është për qëky propozim të hyjë si pikë në rend të ditës?

Me vota unanime, ky propozim hynë si pikë e rendit të ditës.

E hedhim në votim rendin e ditës, kush është për?

Për: 17

Kundër: 13

Abstenim: 0

Me 17për, 13kundër, asnjë abstenim, aprovohet rendi i ditës.

Kalojmë te pika e parë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -III-(tretë) të jashtëzakonshme datë: 13.05.2022 dhe procesverbali nga mbledhja e -V-(pestë) të rregullt datë: 09.08.2022. A dëshiron ndokush të shtojë ndonjë gjë rreth kësaj pike?

Urdhëro Labinot Gashi!

**Labinot Gashi:** Sa i përket procesverbalit kisha kërkut që te fjala ime të ndryshohet në faqe 16, ka qenë që unë jam dakort me i profilizu 3 shkollat e mesme dhe këtu është e cekur 3 shkollat në Drenoc dhe debati që e kam pasur me Drejtoreshën përsëritet disa herë fjala ka qenë për statusin e shkollës jo statutin sepse janë dy gjëra të kundërtat.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Halil!

**Halil Morina:** Me sa e kam pare në email kur ka ardhë materiali nuk ka qenë procesverbal i dhe nuk mundemi me vlerësu kur nuk kemi pasur kohë që ta lexojmë. Nëse kemi diqka mundemi dhe seancën e ardhshme me diskutu.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro Veton!

**Veton Zogaj:** Unë kisha kërkut që procesverbalet të na vijnë më herët dhe të kemi kohë të mjaftueshme që ta lexojmë dhe ta verifikojmë sepse kështu po humbë dhe vëmendja se qfarë kemi biseduar.

**Argjend Thaçi:** Kush është për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së -III-(tretë) të jashtëzakonshme datë: 13.05.2022 dhe procesverbali nga mbledhja e -V-(pestë) të rregullt datë: 09.08.2022. Me vërejtje

Për: 27

Kundër: 0

Abstenim: 1

Miratohet pika e parë e rendit të ditës.

Kalojmë tek pika e dytë: Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë së Bujqësisë përfundimin e korrijeve-shirjeve, për vitin 2022. Për të paraqitur këtë raport ftojë Drejtorin për Bujqësi Sylë Dukollit.

**Sylë Dukollit:** Përshëndetje për Kryetarin e komunës z. Ekrem Kastrati për të gjithë ju asambleistë Drejtorë dhe ekzekutiv. Për të filluar fushata e korrije-shirjeve me datë: 30.06.2022 sipas protokolit, kryetari I komunës ka formu fushatën me 5 anëtarë, që kanë pasur për detyr ta

përcjellin fushaten e korrjeve-shirjeve e cila është emidiate jo vetëm për qytetarët e komunës së malishevës por për të gjithë qytetarët e republikës së Kosovës. Murat Kryeziu ka qenë kryetarë fushate, Remzi Paqarizi, Leotrim Kastrati, Bardhyl Buqaj dhe Gani Kryeziu këta kanë qenë në detyrë sipas aktvendimeve të caktuara që të përcjellin fushaten e korrje-shirjeve në Komunën tonë. Në këtë vitë në Komunën tonë kanë qenë të mbjellura me drithëra të bardha 3587 hektarë, besojë e keni raportin që ju ka dërguar Kryesuesi dhe këto sipërfaqe janë pritë që të korren dhe kanë përfundu, është bërë nën përcjelljen e shtabit I tërë ky proces që ka qenë i formuar nga Kryetari, kanë dalë pothuajse në secilin fshatë ku janë bërë korrje-shirjet dhe kanë shiku se a janë duke u përcjell ato kërkesa ku njëra prej tyre ka qenë e Ministries së Bujqësis, Pylltaris dhe Zhvillimit rural që ka qenë 130E për hektarë. Në bazë të raportit dhe takimit që kam pasur me ta shumica e kanë zbatu këtë vendim. Sipas shtabit niveli i lagështis së grurit ka qenë abdimal. Kanë qenë kushtet e përshtatshme ekologjike për korrje-shirje. Kjo strukturë e paraqitur këtu tregon se në komunën tonë sipërfaqe me grurë kanë qenë 3504 hektarë, Tërshër 45 hektarë, dhe Elbë 38 hektarë. Ky shtab ka vizitu dhe pikat grumbulluese të drithërit ku i kanë dorëzu fërmerët tanë dhe gjithashtu mullinjët ku e kanë vërtetë se a është lagështi në nivel dhe a është në përputhje procesi sipas vendimeve të nxjerra nga Komuna. Të angazhuara kanë qenë 38 autokombanja të cilat nuk kanë qenë vetëm të komunës tonë por kanë qenë dhe të komunave të tjera, vlenë të theksohet se mesatarja në bazë të asaj që kanë aplikuar për subvencione në Ministrinë e Bujqësis del që në këtë vitë për 1 hektarë toka ka paguar afér 3900kg. Fushata korrje-shirje në komunën tonë ka përfunduar me datën 28.07.2022 nga ana e komisionit dhe e Drejtorisëky proces ka përfunduar me sukses.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro Nebih Bibaj!

**Nebih Bibaj:** Faleminderit Sylë në sjelljen e raportit dhe të uroj suksese në detyrën e re. Grupi shtabi emergjent që ka qenë, besoj që ky është marrë me pjesën kur është bërë pjekja e grurit që ndoshta dhe në disa vende janë vonu autokombanjat për korrjen e grurit. Mirë do të ishte kryetarë që ti subvenciononi fermerët me farë dhe plehra sepse në minimum kemi 50% të rritjes së plehrav dhe farave dhe kjo po e ndal mbjelljen e tyre, apo jo subvencionimi i tyre, unë isha ndal më shumë te kjo pjesa sepse është shumë e rendësishme me i përkrah me subvencione dhe me I dhënë vullnet për mbjelljen e tokave të tyre fërmerët që kanë mbi 1 hektarë, sepse janë qmime të papërballueshme të naftit të farave, të plehrave. Megjithatë unë besoj që do të ju ndihmosh dhe të mos shkosh te multikultivatorët, por të ndalesh që ti financosh bujqit që me të vërtet kanë nevoj që ti qosh përpara.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro Valon!

**Valon Mazreku:** Faleminderit Drejtor për këtë raport, po e shfrytëzojë rastin me ta uru poziten e Drejtorit të urojë suksese. Ky raport është I kopizun në kontekstin e titullit që është kriju rapporti. Konsideroj që drejtoria e bujqësis ka shumë aktivitete të cilat ka që ti pasqyrojnë në raportin e Drejtorisë kur ta sjellë.

**Argjend Thaqi:** Fjalen e ka Veton Zogaj!

**Veton Zogaj:** Aktiviteti I Drejtorisë së Bujqësis është pak më i madh por këta janë fokusu vetëm tek korrje-shirje, dhe çdo here është sjellë një raport I tillë nga ana e Muratit. Presim nga ti një

raport më të zgjeruar dhe jo të shkosh hapave të tij. Në drejtori ki dhjetra kërkesa të cilat ja kam dërguar Muratit shpresojmë që nuk I ka humbur fillo nga ato dhe përgjigjiu, dhe këto shpalljet që bëhen publikojë me Emër dhe Mbiemër që ta dimë se kush e ka përfituar serën dhe kush paisjet e tjera, mos i vendosni me kode.

**Argjend Thaçi:** Halil Morina e ka kërkuar fjalen!

**Halil Morina:** Faleminderit Drejtor për raportin ajo që është e rëndësishme për ne e potencoj dhe Nebihu ngritja e qmimit të farave, karburantëve jau vështirëson në masat e madhe bujqësive mbjelljen e tokës me këto produkte që konsiderohen si produkte strategjike sidomos gruri dhe misri. Sot më shumë se kurrë na duhet neve që të mbjellim tokën, dhe që ta mbjellim sa më shumë që është e mundur duhet me e dhënë maksimumin tonë që me ju asistu në mënyrën më të mirë sa kemi mundësi bujqësive tonë, kështu që Drejtorë me e pasur parasysh me u mundu sa më shumë tek bujqësia me qenë prioritet i jonë në këtë kohë. Nëse raporti është për korrje-shirje dhe i ka të gjitha të dhënat kryesore raporti i plotëson të gjitha kriteret e veta, unë mendojë që ky raport na jep të dhënat kryesore dhe shifrat që të shohim sesi ka shkuar korrje-shirje.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro Labinot Gashi!

**Labinot Gashi:** E shfrytëzoj rastin me ta uru poziten e Drejtorit ka nis Nisma që me e thy kufinin administrative, sepse gjithomnë ka përfundu në Drenoc. U tha nga parafolësit që raporti është i kopizun por raporti është i specifikum.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro Mirëlinda Gashi!

**Mirëlinda Gashi:** Dhe unë ja uroj detyrën e re Drejtorit ndërsa pyetja ime për drejtorin është a mundesh me e bë një dallim me vitet e kaluara se sa është punuar toka dhe sa ka arrit këtë vitë të punohet. Është mirë që të punohet toka, sepse dhe rrinqna nuk do të ketë.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Drejtor!

**Sylë Dukolli:** Na kemi biseduar me Kryetarin që ta shpallim një tender përfarë kështu ishte pjesa e buxhetit dhe mbasi është shpallur fituesi është në organet shqyrtuese të prokurorimit dhe jemi duke pritur përgjigje se a mundemi ta arrijmë kohën që është e caktuar. Sa i përket dhënies publike së emrave dhe mbiemrave të cilët i fitojnë subvencionet, në disa komuna i kam parë që janë denuar për shkak të publikimit të dhënavë për arsyet sepse është e ndaluar publikimi i të dhënavë për shkak të mbrojtëjes së privatësis.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit Z.Dukolli për këto përgjigje, fjalen e ka Valon Krasniqi!

**Valon Krasniqi:** Ja urojë Drejtorit poziten dhe e përgëzojë për raportin e konsideroj liderë të lartë të qeverisjes lokale që e ka sjell një përshtatje që sado pak po shihet ana e punës dhe një qasje pak më ndryshe në raporte, dhe ka tentu me përshtatje ministër të bujqësisë dhe në këtë rast nuk do ti mungojë ana profesionale dhe ana bashkëpunuese me ministrin e Bujqësisë.

**Argjend Thaçi:** Te kjo pikë e rendit të ditës nuk duhet miratim, nëse jeni të gjithë të pajtimi shkojmë në pauzë dhe vazhdojmë në ora 13:00. Vazhdojmë me pikën e radhës e cila është: Shqyrtimi dhe miratimi I kërkesës nr.01/1608 datë: 19.09.2022, për ridestinimin e mjeteve nga projektet kapitale. Ftojë Drejtorin për buxhet dhe financa z.Blerim Thaqi që ta marrë fjalën.

**Blerim Thaçi:** Faleminderit Kryesues pëershëndetje për të gjithë. Ne këtu kemi sjell një kërkesë për ridestinimin e mjeteve së pari i tregojmë arsyeshmërit për këtë kërkesë. Në komunitetin për politik dhe financa kemi paraqitur kërkesa vetëm prej cilit kod do të merren mjetet dhe në cilin kod do të shkojnëdhe është kërkuar sqarimi se cilat janë ato projekte dhe jo vetëm me kode. Para jush I keni projektet të cilat janë të paraqitura nëse ka nevojë unë do ti lexojë të gjitha nëse jo ju tashmë I keni të gjithë para vetës suaj. Ju kisha kërkuar që të aprovohet kjo kërkesë me arsyetimin e asaj që të bëhet dhe kryerja e obligimeve ndaj operatorëve që kemi.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit Drejtorë, fjalën e ka kërkuar Valon Mazreku.

**Valon Mazreku:** Këto janë paraqitur disa kërkesa të integrume ku është kërkuar që disa projekte kapitale të ridestinohen për disa projekte të tjera kapitale. Në bazë të asaj që unë kam parë e para është mbulesa e një pjese të obligimeve, e dyta është mbulimi i disa projekteve që janë në buxhet dhe që kur është bërë buxheti është bërë me një kosto tjetër dhe tani kanë disa ndryshime të qmimeve dhe me atë buxhet nuk mund të realizohen duhet të iniciohen me qmime të tjera. E treta me ju shmangë sado pak suficidit buxhetor që për mua të triat janë të arsyeshme. Ka shumë projekte që janë në procedur por që proceduralisht janë të vonuara pak për arsyet e mungesës së alokimit kjo i paraprinë dhe vendimi i kryetarit dhe procedura e prokurorimit, pamundësia dhe koha për me u shpenzu këto mjete na kanë sjellë në këtë pikë që një pjesë të tyre të shfrytëzohen për projekte të cilat mund të përfundohen mbrenda këti viti fiskal. Kjo e lehtëson dhe buxhetin e vitit të ardhshëm, kryerja e obligimeve në këtë vite është një mundësi më e madhe për vitin e ardhshëm që projektet të mos pengohen për shkakë të obligimeve të vitit të kaluar por të vazhdohen ashtu siç janë të buxhetuara. Një e mirë tjetër është se nëse ndokush e keni parë raportin 6 mujor të shtetit kapiali është i shfrytëzuar 11% pra niveli qëndror i ka shfrytëzu 11% dhe për këta 3 mujë tjerë ka mundur të i shfrytëzoj dhe 11% të tjera që i bjen 22% në përgjithësi, shumë prej 700.000.00E me i llogarit për kokë të banorit sipas statistikave i bjen afér 500E mangu në kuletën e qytetarit për shkak të mos shfrytëzimit të buxhetit. Kjo është arsyaja që ne Drejtor e kemi përkrahë që të bëhen këto ridestinime, të kompletohen projektet, të shlyhen obligimet.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Nebih!

**Nebih Bibaj:** Inderuari Drejtor sa i përket ridestinimit të mjeteve unë sa i pashë janë kryerje të obligimeve dhe mos kalimi në suficid, ku ishin më heret këto projekte përsë nuk kanë ardhur në seancat e më hershme, sepse t'i i ke parë që këto mjete janë të rrezikuara dhe projektet nuk janë duke u realizuar. Dhe kisha dashur të di sa prej këtyre projekteve janë duke u realizu në teren, a janë të planifikuara apo a janë duke u përfunduar në teren dhe shumica e këtyre projekteve nuk e

di a janë të kontraktume por këto mjete ti po kërkon që përmes këtyre kodeve buxhetore të bartën në projekte të cilat kanë me u realizu dhe këto projekte të cilat nuk janë të kontraktume dhe t'i po kërkon që të tërhiqet buxheti prej një kodit në kodi tjetër si kryhet pagesa përderisa nuk kanë kontrat? Sa % e buxhetit është realizu, dhe ato projekte të cilat nuk gjejnë realizim sepse tashmë jemi afër muajit titorë dhe një muaj vëq përfundojnë, qka do të bëhet me ato projekte? Siç dihet në projekt-buxhetin e këti viti të cilën ju e keni paraparë me theks të veqant qëështë i vitit 2023 shumica e këtyre projekteve nuk figurojnë nëprojekt buxhet, atëherë a do të mbeten në stagnum ato projekte të pa realizuar apo qfarë do të bëhet me ato projekte?

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Veton Zogaj!

**Veton Zogaj:** Në mbledhjen e KPF-së ka pasur vetëm kode dhe nuk ka pasur emra të këtyre projekteve se ku do të realizohen këto mjete. E kuptojë drejtë kërkesen e drejtorisë për financa që po e bënë këtë ridestinim që të i ik suficit buxhetor në fundë vit, mirëpo nuk po mundem me e kuptu pse janë disa projekte që kërkohen të ju tërheken mjetet ndërsa figurojnë në projekt-buxhetin e vitit 2023. Ka disa projekte të cilat janë të përfunduara siç është projekti i muzeut të pajtimit të gjaqeve nëfshatin Bubavec që të gjithë e dimë që ka përfunduar dhe i është prerë shiriti për hapje, ndërsa këtu po kërkohet të ju tërheken mjetet dhe në të njejtën kohë po kërkohen mjete shtesë për me u realizu në vitin 2023. Po ashtu projektet për rregullimin e ujësjellësve në fshatrat Tërpezë, Bellanicë, Pagarushë dhe disa fshatra të tjera si dhe tash po kërkon me i tërhek mjetet me i ridestinu në projekte të tjera dhe në anën tjetër keni vendos projekte të reja në projekt-buxhetin për vitin 2023. Dhe dua të di çka po ndodhë me ndërtimin e tribunës veriore na kemi ridestinu mjete për këtë projekt dhe prap është në projekt-buxhetin e vitit 2023 që kërkohen mjete shtesë për realizimin e këti projekti por në anën tjetër ne ja kemi dhënë klubit në shfrytëzim për 15vite, realisht është ndesh me ligjim sepse na e kemi bartë klubit si pronësi për shfrytëzim të saj dhe na me i dhënë mjetet tona për një pronë qëështë 15 vite që mund ta quajm kushtimi pronë private e klubit.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Burim!

**Burim Paqarizi:** Përvendetje për të gjithë!

Një pyetje për Drejtorin te ndërtimi i rrugës anësore te Lumi Mirusha në Malishevë shuma prej 154.000E të ridestinohen për rregullimin e rrugës "Ibrahim Mazreku" në Malishevë. Gjendjen e këtyre shetitoreve e dimë të gjithë kemi fillu me bërë diqka i kemi vendos disa anësore dhe ka mbet ashtu që nuk është e kalueshme as në ecje. Dëshirojë të di se si mundemi me i ridestinu kur nuk kemi ende një kontrat të nënshkruar për rregullimin e rrugës "Ibrahim Mazreku" dhe a janë të parapara me përfundu mbrenda këti viti?

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valjetë Hoti!

**Valjetë Hoti:** Tek kjo kërkesa për ridestinimin e mjetave janë dy projekte ku i njëjti projekt është i paraqitur dy here është ndërtimi i palestrës sportive në shkollën e mesme "Lasgush Poradeci" në Kijevë shuma prej 40.000E të ridestinohet në projektin ndërtimi i Garazhdave të automjeteve

të QKMF-së, prapë është i njëjti projekt mirëpo në këtë rast është shuma prej 30.000E ku ridestinohet në projektin renovim i jashtëm dhe i pullazit të objektit të QKMF-së pra është i përsëritur i njëjti projket.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Labinot Gashi!

**Labinot Gashi:** Deshta me u lidhë me atë që tha kolegia pasi që jam professor i asaj shkolle është mirë që kur të bëhet ridestinimi i mjeteve secili prej tyre të ketë arsyeshmërin, pratë tërhiqen mjetet nga një projekt që është i bartur qe tri vite ku janë afër 400 nxënës dhe po i jep përparsi projektit tjetër psh. Ndërtimi i garazhdave, a më e rëndësishme është ndërtimi i palestrës në një shkollë apo ndërtimi i garazhdave në QKMF. Disa projekte të rrugicave unë i shoh që janë tërealizuara por këtu prap po kërkohen ridestinim mjetesh për ato.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit Labinot, kërkoj nga Drejtori tu përgjigjet pyetjeve të anëtarëve të Kuvendit!

**Blerim Thaqi:** Faleminderit Kryesues, vetë fakti që kanë qenë të kontraktume dhe punimet kanë përfunduar jemi në obligim pér ato rrugë dhe pikërisht ridestinimi shkonë pér ato punime që kanë përfunduar. Tek qështja e bartjes së mjeteve të palestrës sportive pér shkak të procedurave që nuk mund të zhvillohen nga vendimi i projektit të palestrës sportive në shkollen “Lasgush Poradeci” i kemi destinu pér projekte që janë në realizim dhe që do të përfundohen. Janë të ridestinume nga dy kode është fjala nga të hyrat vetanake dhe landës specifike, janë prej të njëjtë projekt por ne duhet me i specifiku prej cilës vijnë. Tek qështja se a janë të gjitha këto projekte të kontraktume, mbi 90% të projekteve janë të kontraktume dhe janë duke vazhduar punimet, përjashtim vetëm procedurat që kemi menduar që do të përfundojnë në fund të javës kontrata e rrugës “Ibrahim Mazreku” dhe sipas planit dinamik të paraqitur nga Urbanizmi është dashur të sigurohen mjete që të realizohet ky projekt pér vitin 2022 dhe të mbyllët kontrata në vitin 2023 si tëresi.

**Nebih Bibaj:** Trotuarët që janë ende nuk kanë filluar a i ki kontratat?

**Blerim Thaqi:** Janë dhe 300.000E që do të realizohen në pjesën e shtrimit të këtyre trotuarëve, gjithashtu dhe rrugët e tjera nuk kanë përfundu të gjitha por kemi rrugë që kanë përfundu dhe në pjesen e Kijevës, Bellanicë, Banjë pér të cilat duhet të kryhen obligimet. Procedurat e lapidarëve disa kanë përfunduar dhe disa kanë filluar por nuk mundemi të i shpenzojmë të gjitha dhe është menduar të ridestinohen pér realizimin e projekteve të tjera. Muzeu është përfunduar me një buxhet tjetër jo nga Malisheva. Sa përqind është realizo buxheti?

Tashmë na e kemi dhe raportin që do ta prezantojmë në fund të shtatorit por një analizë i kemi bërë në aspektin e përgjithshëm ka fundi i korrikut buxheti i shpenzimit ka qenë afër 64%, afër 30% të shpenzimeve kapitale janë shpenzu mjetet shpresojmë që në muajin shtator do të jetë një shpenzim i kënaqshëm me gjithëse kemi dhe tre muaj që të kryhen shpenzimet. Tek qështja e ujësjellsit që e cekti Vetonit, dhe këtu nuk kemi pasur mundësi të fillojmë procedurat pér realizimin e atyre investimeve dhe kemi paraparë që të jetë një investim i përgjithshëm i

ujësjellsit në nivel Komunal në vitin 2023, dhe të futen brenda një projekti të përbashkët për realizimin e ujësjellsit nëpër fshatra. Projekti i stadiumit është investu dhe është duke vazhdu me u investu dhe duhet të ridestinohen mjetet për realizimin e punimeve që përfundohen në stadium. Stadium i qytetit i është dhënë në shfrytëzim dhe nuk i është dhënë me u bërë pronar klub, për këtë arsy që Komuna do të fillojnë ndarjen e investimeve për ti ju mundësu kushte më të mira për aktivitet sportive.

Projekti rreth Lumit që e ceku kolegu pse nuk është realizuar, aty kemi probleme pronësore dhe nuk ka mundur të përfundojë projekti për këtë arsy janë ndalë punimet dhe mjetet që kanë mbetur pa shfrytëzu i kemi ridestinu në pjesën e rrugës “Ibrahim Mazreku” do të fillojnëpunimet shumë shpejtë dhe do të realizohet pjesa siç është e parapame në planin për vitin 2022.

**Argjend Thaqi:** Faleminderit Drejtor, urdhëro Valon Krasniqi!

**Valon Krasniqi:** Po kërkoj një sqarim nga Drejtori i Urbanizmit, a ke informacione se cilat rrugë para 5 ditësh kanë përfundu në fshatin Bardhë? Për arsy se këtu është e cekur rruga “Rifat Bellani” që duhet bartur mjete për këtë rrugë, por kjo rrugë tashmë është e përfunduar.

Drejtor janë dhe disa rrugë të tjera të cilat nuk janë të përfshira këtu faktikisht ato kanë qenë prej legjislaturës së kaluar, a kanë përfunduar, apo janë në process sepse nisur nga fshati prej nga vi unë janë 5-6 rrugë të cilat janë bartë, 2 paskan përfunduar mirëpo për 4 rrugë të tjera nuk po shohë ndonjë të dhënë qfarë po ndodhë me ato rrugë.

Te qështja e shtrimit të trotuarëve përse nuk figuron fare rruga “Afrim Krasniqi” kanë qenë 550m trotuar, në aspektin ligjor duhet të përfundonte në vitin 2020, jemi në vitin 2022 ne ende nuk kemi përgjigje se kur do të fillojnë këto punime.

Drejtori i Urbanizmit është duke bërë politik me taksa të qytetarëve po ashtu me projekte që i takojnë legjislaturës së kaluar të z.Ragip Begaj.

**Argjend Thaqi:** Faleminderit Valon, urdhëro Mirëlinda Gashi!

**Mirëlinda Gashi:** Unë jam e pajtimit që te disa projekte të bartën te disa pika, por te disa pika nuk jam e pajtimit, sepse në këtë rast nuk po fiton qytetari por po është humbës, kështu që të kemi kujdes se çka po votojmë. Unë kam dëshirë që këto pika të shkojnë në votim një nga një.

**Argjend Thaqi:** Faleminderit Mirëlinda Gashi, urdhëro Drejtor!

**Blerim Thaqi:** Ne nuk mund ta votojm një nga një, sepse nuk e dim se sa është borgji. Projektet që janë prezantuar para jush një pjesë e tyre nuk do të realizohen për shkak të procedurave të prokurorimit që kanë stagnu dhe për arsy se alokimi i mjeteve ka qenë me vonesë. E përmendi dhe Nebihi që kemi projekte të 2019, arsyja është sepse kemi votuar buxhet të kontraktuar dyfish jashtë kostos së buxhetit me të cilin kanë pasur që të përfundohen ato projekte.

**Argjend Thaqi:** Urdhëro, Nebihi!

**Nebih Bibaj:** Në mars e keni votuar një projekt-buxhet ju, sa përqind e ati projekt-buxheti është realizu në teren?

Një rrugë ku unë jetoj është 300m dhe nga vitit 2017 është në projekt-buxhet dhe ende është e parealizuar. Është në projekt buxhet për këtë vit dhe thojnë që nuk mund të realizohet deri në vitin 2024. Kjo me të vërtet është shqetësuese.

Trotuari i lagjes Balaj 4 vite ka qenë në projekt buxhet dhe nuk ka gjetur realizim. Më mirë të merresh me projektet që nuk kanë mundur të gjejnë realizim, sepse irritohet qytetari dhe të gjithë ju keni me pas problemin direkt, sepse ju jeni ekzekutivi, ne mundemi vetëm të ju asistojmë vetëm për arsyet e suficidit. Bëhu më i qartë dhe do ta kesh gjithmonë bashkëpunimin tonë.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Nënkyrytar!

**Vesel Krasniqi:** Faleminderit Kryesues, ridestinimi lejohet me ligj, rishikimi i buxhetit që zakonisht bëhet në Qershori, Qeveria qendrore nuk na ka lejuar që ta bëjmë. Buxheti në Mars është votuar, në Maj është aloku dhe gjysma e vitit veç ka përfundu. Pra, të gjitha këto kanë ndiku që ne të kërkojmë një ridestinim të mjeteve që na lejon ligji, të gjitha këto projekte që po i cekum se nga mi marr dhe kujt me ja destinu janë të votuara, nuk ka ndonjë projekt të ri që po kërkojmë me mbulu me mjete.

U përmend ngritja e qmimeve një prej faktorëve, alokimi me vonesë, procedurat në ASHP të gjitha nga këto ne po pajtohem që mos ta lejojmë që të shkojnë në suficid. Ky ridestinim pa bindje politike është për qytetarët e Komunës së Malishevës, jemi në një situatë të vështirë ekonomike si vend në nivel qëndror ka dështu shfrytëzimi i buxhetit sidomos te kategoria e investimeve kapitale, dhe sigurisht ka pasur impakt dhe te nivelet lokale. Në tribuna ju kemi borxh besojë që me kalimin e kohës do ta kalojmë dhe ato borxhe që ju kemi mbetur ndokujt. U përmend Muzeu në Bubavec, për të cilin ka financuar agjensioni dhe ato mjete kërkojmë me i ridestinu në projekte të cilat mendojmë që mund të përfundojnë këtë vit. Ambulanca ka ecur më shumë sesa ne kemi planifikuar për këtë vit i kemi pasur të alokume 155.000E dhe operatori ekonomik ka avancu është nënshkruar kontrata dhe mundet me përfundu më shumë, ne i kemi zgoglu mjetet, sepse llogarisim që të shpenzohen më shumë këtë vit.

Te rrugët kur pyeten se pse nuk kanë përfunduar ato rrugë por prapë figuron në ridestinim, projekti si emërtim nuk mundet me u ndryshu nuk mundemi të i tërhekim disa rrugë por duhet të jetë në plotëni.

Afër 65% e buxhetit është shpenzu deri në fund të korrikut dhe sa projekte kanë përfunduar është një pyetje tjeter sepse duhet të bëhet një pasqyr dhe kur do që dëshironi mundemi me e brëë dhe me ju sjellë.

I cekët trotuarët, ne kemi menduar që operatori ekonomik mundet me i përfundu, por nuk ka mundur dhe këtë vit nuk ka pasur mjete të ndara mjaftueshmë ne kemi llogarit që të ndahen mjetet për trotuarët të cilët ende janë duke u shtruar besoj që dhe në Lladroc do të përfundojnë të gjitha të cilat janë të kontraktume në fund të këti viti.

U përmend dhe stadium, ne e kemi dhënë në shfrytëzim por nuk ta ndalon ligji investimin në stadium sepse ai është aset i komunës ne nuk ja kemi falur por vetëm ja kemi dhënë në

shfrytëzim, ky projekt është në fazën e dytë është i pa përfunduar dhe nuk mund ta lëjmë në gjysmë.

E bëtë pyetjen se përse kemi kërk me ju nda mjete të bartura në këtë projekt, për arsy se ka qenë munges e ndarjes së mjeteve në vitin 2021 dhe ne kemi mendu që me të bartura të përfundojë, ky është një projekt i fazës tjetër me mbules, ulëse, nxemje etj.

E cekët që po përsëriten të njejtat projekte dhe në vitin 2023, projektet të cilat janë të miratuarë në këtë vit ne kemi kërkuar me i planifikuar në vitin e kalum që kemi menduar mjaftueshmë do të përfundojnë për arsy të qështjes kohore. Tani i kemi një mori projektesh në procedurë të kontraktimit, jemi të sigurt që ato nuk mundemi të i përfundojmë këtë vit për këtë arsy kemi kërkuar që të figurojnë shuma solide dhe në vitin 2023 në mënyrë që të përfundojë kontrata.

Te shetitorja është një problem për qështje pronësore, kur është bërë projekt i është bërë me matje gjeodezie dhe kanë dalë probleme dhe projekt i cili ka qenë i detajuar nuk ka mundur të zbatohet, prandaj ne e kemi ndërprerë kontratën dhe do ta përmisojmë projektin, do ta hetojmë planin dhe do ta shëndrrojmë në shetitore. Pra do të bëjmë modefikim të projektit me marrveshje të operatorit ekonomik për arsy të problemeve me prona private.

Rugua "Ibrahim Mazreku" është projekt dy vjeqar 2022-2023, ne kemi menduar që do të fillojë më herët të paktën një muaj por presim në të premtën që do të mbahet seanca në organin shqyrtues, sipas kontakteve që kemi me operatorin përtëj planifikimeve tona që ne i kemi planifikuar 300.000 për këtë vit do të shpenzohen për këtë projekt por ata kanë shprehur gatishmërin që të punojnënë në dy ndërrime dhe deri në shumë 1.000.000.00E do të jem të gatshëm të shpenzojë deri në fund të vitit, prandaj nëse e vërejmë dhe buxhetin e 2023 ne e kemi zbrit vlerën dhe me ridestinim ne kemi planifikuar që afër 1.000.000.00E të shenzohen për këtë projekt, prandaj e kemi zgjedhur vleren tek viti 2023.

E ceki asambleistja Valjeta, pse po përsëritet projekt tek Garazhdat, janë disa nën projekte të cilat janë të cekura te projektit Garazhdat të cilat janë oborri, rrëthojat, dhe është objekti si projekt është një, ne kemi tërhek në draft që e kemi pas pullazin me fasad sepse ai po përfundon këtë vit. Por tek garazhdat është planifikuar që të bartet një shumë.

Labinot, Blerimi e tha që është për shkak të projektit, ajo pak na ka shkaktuar puna e pozitës, mjetet të cilat I kemi poseduar nuk kemi mundur ta përfundojmë me 70.000E. Prandaj ne kemi angazhuar operatorët që ta bëjnë një projekt tjetër, që ti përshtatet pozitës dhe është kogja problematike për shkak të hapsirës.

**Labinot Gashi:** Ne e dimë që ridestinimi është plotësishtë i ligjshëm, mirëpo projektet të cilat tërhiqen është shqetësuese, qe tri vite është bartë si projekt, pra nuk është projekt i këti viti. Konsideroj që është projekt që ja vlenë me u përfundu, mirëpo është shqetësuese për mua që po më kërkohet të tërhiqen mjetet prej atij projektit. Të gjithë qytetarët e dinë që është projekt i buxhetuar qe tri vite, tani po vjen në një situatë që me e tërhek komplet projektin për këtë arsy duhet të bëhet një analiz. Më mire është që këto mjete të dërgohen në projekte që janë më të rëndësishme sesa me i dërgu në projekte të dështuara.

**Argjend Thaqi:** Faleminderit Labinot, urdhëro Nënkyrytar!

**Vesel Krasniqi:** Është në interes të gjithëve që të shpenzohet sa më mirë buxheti, ti shfrytëzojmë këto mundësi dhe të i ridestitojmë, sepse jemi në një afat të caktuar.

**Argjend Thaqi:** Faleminderit Nënkyrytar, urdhëro Nebih bibaj!

**Nebih Bibaj:** Palestra në Kijevë mendoj që duhet të jetë në buxhet të vitit 2023-2024, nëse nuk është në planifikim të vitit 2023-2024 me të vërtet është shqetësuese për atë pjesë.

**Vesel Krasniqi:** Mundemi me e vendos në projekcion të vitit 2024.

**Argjend Thaqi:** E hedhim në votim shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1608 datë: 19.09.2022, për ridestinimin e mjeteve nga projektet kapitale me projekzion të vitit 2024. Kush është për?

Me vota unanime aprovohet kjo pikë e rendit të ditës. Kalojmë te pika e radhës Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/831 datë: 31.08.2022 për projekt-buxhetin për vitin 2023-2025, me theks të veqant për vitin 2023. Për prezantimin e kësaj pike fjalën e ka Kryetari!

**Ekrem Kastrati:** Kjo kërkes e imja ka për qëllim të që ta miratojë buxhetin e vitit 2023-2025 me theks të veqantë për vitin 2023. Ky projekt-buxhet për vitin 2023-2025 është 18,124,837.00E, që krahasuar me vitin e kaluar kemi një buxhet më të lartë. Dua të theksoj që ky buxhet ka për qëllim përfshirjen e të gjitha interesave të qytetarëve të komunës së Malishevës me fokus të veqantë në zhvillimin ekonomik. Kur jemi te ky projekt-buxhet dua të përmendi dhe faktin që për vitin 2023 kemi të aprovuar 20 vende të reja të punës që të angazhohen në qerdhet e reja si dhe në sektorin e shëndetësisë dhe arsimit që do të thot 58 vende të reja të punës. Po ashtu ky projekt-buxhet ka të bëjë me fushën e arsimit që programe për arsim janë 8,046,916.29, pastaj programi për shëndetësi e buxhetit është 2,578,757.48. Ju e dini që projekt-buxheti i komunës sonë ka shkuar 80% nëpër fshatra apo në pjesën rurale kurse në qendër nuk kemi investuar me thënë shumë pak, prandaj ne dëshirojmë që buxheti i ardhshëm të jetë një buxhetim inkurajues që e nxitë zhvillimin e Malishevës dhe ja ndryshon imazhin e komunës sonë. Tashmë e kemi përmbyllur projektin e rrujës "Ibrahim Mazreku", ju do të thirreni në një seancë të jashtëzakonshme besoj në javën e ardhshme dhe do ta shihni projektin. Shpresojë që projektin ynë do të realizohet ashtu siç ne po dëshirojmë. Idetë e juaja janë të mirëseardhura si për projekt-buxhet ashtu dhe për pikat tjera që i cekëm.

**Argjend Thaqi:** Urdhëro, Hali!

**Halil Morina:** Përrshëndetje për të gjithë!

Këtu po e shohim një ndryshim krahasuar me mandatet e tjera. Në mandatet e kaluara ne jemi fokus më shumë në investime të cilat janë në fshatrat tona, tanë kemi kaluar në një nivel tjetër. Përqëndrimin e buxhetit e kemi bërë në qytetin tonë, ndërsa në fshatra e kemi bërë një kontrat për mirëmbajtje vetëm për investimet që i kemi bërë deri tanë. Nëse e shohim rrugën "Ibrahim Mazreku" zgjerimi dhe rregullimi i kësaj rruge përveq që ja shton dimenzionin estetik qytetit ajo krijon dhe lehtësi të mëdha. Pra, ky është një investim për qytetarët e komunës së Malishevës.

Në mmomentin që jetësohen këto projekte të hyrat tona do të rriten. E mira e këti buxheti është edhe rritja e numrit të punësuarve në arsim dhe shëndetësi, të gjithë e dimë se sa ka nevojë komuna jonë për personel në shëndetësi dhe në arsim. Dhe një vërejtje që e dhanë në fillim është mirë që herave të tjera të bashkëpunoni me të gjithë asambleistët nuk besoj që e keni shmangur bashkëpunimin vetëm për arsyet se këta janë opozit, por nganjëherë neglizhenca, por është mirë që herave të tjera të mos përsëriten këto gjëra sepse secili nga ne në mënyrën e vet mundohemi me e bërë më të mirën për qytetin tonë.

**Argjend Thaqi:** Urdhëro, Drejtore!

**Blerim Thaqi:** Dua ta japë një sqarim që në si qeveri komunale e kemi bërë përgaditjen konformë anës ligjore për hartimin e projekt-buxhetit. E përmendët që projekt-buxheti është dashur të dorëzohet me 30.08.2022 në kuvend. Por neve në fund të gushtit na ka ardhur qarkorja e dytë dhe ne kemi filluar me dëgjime publike pa na ardhur ende qarkorja e dytë. Kemi përgadit buxhetin e kemi dorzu në komitet, pastaj komiteti në Kuvend. Në kuadër të kësaj më vonë kemi pasur kërkesa nga qytetarët, komiteti, dhe nga akterët e tjerë që të plotësohen disa kërkesa në projekt-buxhetin që e kemi dorëzu tani tek ju. Kërkoi nga kryesuesi që të hudhen në votin kjo pjesë me ndryshime, Kërkes për disa ndryshime është në kodin 51244 të tërheket vlera prej 100.000.00E dhe të bartet për projektet e asfaltimit të rrugëve nëpër fshatra. Në projektin 51055E të tërheket vlera prej 200.000.00E dhe të bartet në projektin asfaltimin e rrugëve nëpër fshatra prap. Në projektin 51771 të tërheket vlera prej 50.000.00E të bartet tek projekt kodi 51769, nga projekt kodi 51771 të tërheket vlera prej 200.000.00E dhe të barten tek projekti asfaltimi i rrugëve nëpër fshatra, kryesisht janë dhe emërtimet e rrugëve por do ti fusim në buxhet për cilat rrugë dhe cilat fshatra bëhet fjalë. Nga projekti 51771 të tërheket vlera 100.000.00E dhe të bartet tek projekti i ri rruga “Hamdi Berisha” projekti i stadiumit dhe oborri i qendres sportive. Nga projekti 51792 të tërhekut komplet projekti në vlerë prej 100.000.00E dhe të bartet në një projekt kodin 51793. Nga projekt kodi 51807 të tërhekut vlera prej 5000E dhe të bartet në projekt kodin 51806. Nga projekt kodi 51805 të tërhekut vlera prej 15.000.00E dhe të bartet në projekt kodin 51808. Nga projekt kodi 51771 të tërhekut vlera prej 50.000.00E dhe të bartet në projekt kodin e rregullimit të oborrit të shkollës fillore në Astrazup. Nga projekt kodi 50724 të tërhekut vlera prej 30.000.00E të barten në projekt kodin e rregullimit të lapidarëve nëpër fshatra. Dhe po e fusim kërkesen që si projeksion të hyjë dhe salla sportive e shkollës së mesme “ Lasgush Poradeci” në Kijevë. Rugët të cilat i përmenda në këto projekte janë: Fshati Ngucat 630m, Kravasari 770m, Llapqevë 550m, Mirushë 330m, Turjakë 800m, Astrazup 850m, Rud 700m, Panorcë 650m, Pagarushë 900m, Tërpezë e poshtme 1100m, Shkarashnik 500m, Lubizhdë 600m, Banjë 1000m, Gajrak 640m, Gurisht 700m, Carrallukë 400m, Gurbardhë 600m, Burim 500m, Dragobil 400m, Lladroc 200m, Gullubovc 170m.

**Argjend Thaqi:** Urdhëro, Nebih!

**Nebih Bibaj:** Jemi pro që qendra të rregullohet, sepse ka mbetur shumë keq por prap dyshimet tonë janë që nuk përfundojnë me këto mjete financiare. Po frigohemi që e fusim qytetin në një

katrahur që nuk mundemi me dal për arsyet që ti fillon investimet dhe nuk ka mjetë të mjaftueshme me i përfundu dhe mbet qyteti ashtu. Do ishte mirë që me shiku ndonjë burim nga neveria apo nga ndonjë organizatë ndërkombe të me pas donacione që me e vazhdë projektin deri në fund. Kryetari e tha që tani kemi me ju ftuar juve që me e pa se si është projekti këtu në projektor, nuk e di ku është problemi sepse është dashur me u thirr të gjitha subjektet dhe gjithë akterët e mundshëm para se të nënshkruhet kontrata ta dimë se qka ka me u punu në atë drejtim. Dhe sa i përket buxhetit unë mendoj që është dashur të i ndjek disa hapa. KPF-ja është dashur të dal nëpër fshatra dhe t'i mbajnë dëgjimet publike, siç i ka hije dhe siç kanë bërë komunat e tjera. Nënkyetari tha që është projekt 3vjeqar, mos po mbesim keq te kanalizimet dhe te rregullimet e trotuarëve.

Te pjesa e projekt buxhetit të vitit 2022 e cekët që 66% e buxhetit është shpenzu, por nuk dihen cilat projekte janë realizu. Unë besoj që kolegët nga KPF-ja kanë kërku që të vjen një raport i detajuar siç kemi kërkuar çdo miratim të buxhetit. Cilat projekte janë në realizim dhe cilat kanë përfundu që mos të përsëriten çdo herë të njëjtat projekte. Unë shpresoj që ky projekt ka me gjetë zbatueshmëri. Te bujqësia dhe te arsimi, prapë kisha pas dëshirë që me u rrit kodet buxhetore sepse me të vërtet ka nevojë.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Kryetar!

**Ekrem Kastrati:** Projekti i sheshit është projekt ideor, jo projekt përfundimtar. Projektin e sheshit e ka fitu kompania e cila e ka bërë projektin ideor që e ka seleksionon komisionin. Kur të nënshkruhet kontrata e projektit ideor vazhdojmë me projektin e përgjithshëm me statik dhe me shumën e përgjithshme se sa ai projekt kushton. Tani për tani ne nuk e dimë se sa kushton rregullimi i sheshit, sepse kompania e ka vetëm projektin ideor dhe ju keni me i dhënë vërejtjet e juaja. Javën që të vjen do ju vie një ftesë për mbledhje të jashtëzakonshme që ta shihni projektin ideor. Te rruga "Ibrahim Mazreku" Drejtoria e Gjeodezis dhe Kadaster i ka identifiku të gjitha pronat publike të cilat janë të ozurpume për rreth asaj rruge dhe ju ka dhënë nga një shkres që tregohet se i ke uzurpu 2m katror dhe nëse nuk ke dokumentacion shtesë atëherë nuk ke të drejtë ankimi.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit Kryetar, fjalën e ka Valon Krasniqi!

**Valon Krasniqi:** Përshendetje për të gjithë!

Kryetar, së pari po ju jap kritikat, vrejtjet dhe në fund propozimet. Ne është dashur të punojmë të gjithë së bashku pozitë dhe opozit në këtë vendim kaq të rëndësishëm, por kush është penguesi më i madh, rreth qështjes më të madhe që sot po e diskutojmë në këtë seancë pra për buxhetin e komunës së Malishevës në tërësi për vitin 2023-2025. Për hir të llogaridhëni dhe opinionit publik më duhet të theksoj që penguesit më të mëdhenjë ngelen pikërisht ata individ të cilët përpilojnë buxhet në fund fare nuk është përgjegjësi e tyre ligjore miratimi dhe vërtiti final për buxhetin. Buxhetin e komunës nuk e miraton as kryetari i komunës, as drejtorët dhe as nën kryetari, buxhetin e miraton organi më i lartë institucional komunal, pra kuvendi. Sot në këtë seancë ne para vetës kemi një buxhet të servuar njëanshëm me plotë mangësi, dhe e kemi një

buxhet ku nëpër fshatra parashihen 0 buxhet. Sot tregohet qartë që dëgjimet publike dhe kërkesat e shumicës së kryetarëve të fshatrave janë injoruar totalisht dhe kjo krejt si pasojë e një keq qeverisje të vazhdueshme. Ky buxhet do të duhej të vinte i hamonizuar me kërkesat e qytetarëve të shumicës së fshatrave dhe jo i gjysmuar. Ky buxhet do të duhej të vinte i plotësuar për ta miratuar me vullnet, solenmisht dhe unanimisht. Dhe të gjitha këto do të ndodhnin aq thjeshtë të punonit sinqerisht dhe bashkarisht. Ju Kryetar apo ju zyrtarë të cilët bëni të tilla sërvimesh mund të ju duket roli i asambleistave një rol jo i rëndësishëm dhe tentoni të i përdorni si vegla ditore, ta dini ju që roli i çdo asambleisti komunal është aq fisnik dhe aq me dinjitet dhe vendimarrje sa që ju nuk e imaginoni. Andaj boll më me këtë injorancë dhe me këtë mos seriozitet për asambllen komunale, sepse ne jemi të zgjedhurit e qytetarëve për të përpiluar, orientuar, miratuar buxhet dhe jo dikush tjetër nga jashtë.

Uroj që në një të ardhme të ketë grupe punuese nga kuvendi, ku mund të kenë qasje para akteve të përfunduara. Duke e ditur faktin që është aq e vështirë të kalohet ndonjë kërkesë me këtë mentalitet qeverisës, kam disa kërkesa si përfaqësues i qytetarëve që në numër nuk janë të shumta sepse jemi të vetëdijshëm që vështirë janë të kalueshme andaj nuk preferoj që në këto pika kaq esenciale të bëjë politikë.

Propozimet e mia janë që në fshatin Dragobil parkingu i shkollës “Emin Duraku” të hyjë në këtë projekt buxhet, në fshatin Balincë ndriqi publik rruga “Martirët e Kelmendëve”, në fshatin Bardhë vendosja e gypave dhe rregullimi i rrjetit të kanalizimeve dhe ujravve të zeza në rrugën “Ahmet Krasniqi”, po ashtu asfaltimi i rrugëve 750m dhe ndriqi publik në rrugën “Ahmet Krasniqi” dhe rruga “Berat Berisha”.

E dëgjova me vëmendje kryetarin që tha kësaj radhe buxheti do të fokusohet më shumë në qytetëzë dhe unë pajtjohna me këtë dhe propozojë që në parkun e qytetit apo në sheshin e qytetit të vendoset shtatorja e presidentit historik Dr. Ibrahim Rugova. Unë si përfaqësues i qytetarëve kamë të drejtë të i bëjë këto propozime.

### **Argjend Thaqi: Veton Zogaj e ka kërkuar fjalën!**

**Veton Zogaj:** Nëse e bëjmë një analiz nga vitet e kaluara Komuna e Malishevës nuk ka pasur asnjëherë një ngritje kaq të madhe të buxhetit. Më gjëzon fakti që për arsyen e reformës në administratë dhe reformës në ekonomi hapat që i ka marrë niveli qendror ka bërë që të ngritet dhe numri i puntorëve në sektorin publik në Komunën e Malishevës, dhe në QKMF-ë është rritur, po ashtu dhe kategoria për subvencione. Sa i përket buxhetit një nga fjalimet e mia të parat që ka qenë në kuvend është draftimi i buxhetit në vitin 2022 dhe atëherë Kryetari, Nën Kryetari dhe Drejtori i Financave u patën zotu publikishtë që draftimin e buxhetit për vitin 2023 do ta bëjnë së bashku me opoziten, unë e kuptoj që qeverisja e drafton dhe e konsulton pastaj me aktet e tjera mirëpo nuk është bërë kjo. Ne ju kemi thënë e keni mbështetjen tonë aq sa jeni bashkëpunues me ne, por jemi refuzues ndaj kërkesave të juaja në këtë rast për buxhetin për aq kohë që ju i mbyllni këto linja komunikimi.

Çka kam parë në buxhet po ndalem te investimet kapitale është një koncentrim i madh në qendrën e qytetit, afér 80% e buxhetit është në qendër, por është gabim të injorohen fshatrat dhe

të lihen pas dore një vit kalendarik dhe rrezikon me qenë dhe viti 2024 pa investime kapitale në këto fshatra. Po ashtu janë disa fshatra që janë të parapara në projekt-buxhet, por janë rrugë shumë të shkurtëra me 200m, 100m.

Dyshoj shumë në realizimin e këtyre dy projekteve madhore që po i quan qeverisja, sepse e ka dhënë shembullin e projektit madhorë rreth lumbit Mirusha që ka mbetur në gjysmë dhe prapë po kërkohen mjete për rregullimin e këti projekti dhe në anën tjetër nuk e dimë se qfarë ka ndodhur me 700.000.00E që kanë qenë për këtë projekt.

Projekti për rregullimin e rrugës “Ibrahim Mazreku” në qendër të qytetit një diskutim që e kam pasur me Kryetarin realisht na pajtohum që kjo rrugë donë tretman dhe donë që një herë e përgjithmonë me u rregullu dhe me e zgjedhi problemin e fluskut të madh të qytetarëve. Është dashur të bëhet një plan për menaxhimin e kolonave dhe fluskut të madh të qytetarëve se nga kanë me frekuentu qytetin nëse këto rrugën kanë me qenë më shumë se dy vite të myllura për qytetarët. E kemi një mini tranzit nga lagjia Hoti që del në lagjen Mirdita dhe te shkolla e Kompetencës, i cili nuk e plotëson kriterin minimal me përballu këtë fluskë të madh të qytetarëve. Kryetar, paraprakisht është dashur para se me e sjellë projektin me na tregu zgjidhjen të cilën e keni parapa për qarkullimin e qytetarëve gjatë kësaj kohe që janë duke punuar në rrugën “Ibrahim Mazreku”. Po ashtu projekt i dytë madhor që po e paraqet qeverisja komunale është rrugullimi i parkut të qytetit, uroj të bëhet projekt siç i ka hije, mirëpo dyshojë shumë se me këtë shumë e cila është parapame 800.000.00E vetëm kemi me bërë gërmazh këtu dhe nuk do të mundemi të bëjmë këtë projekt që është paraparë. Uroj që të bëhen mirë këto planifikime dhe mos me pas probleme.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit! Fjalën e ka Burim Paqarizi!

**Burim Paqarizi:** Për këtë dy projekte kaq të mëdha për Komunën e Malishevës ne nuk e kemi parë asnjë detyrë projektuese, sepse zakonisht detyrat projektuese kalojnë nga komuna ose ai që e jep detyrën projektuese e dim çka ka me ndodhë me projektimin ose me fazën e projektimit. Në fazën e parë të projektimit është dashur të dimë a do të kemi parkim nëntokësor në pjesën e sheshit të qytetit apo nuk do të kemi. Te pjesa parkimi nëntokësorë nëse vetëm ekziston si parking nëntokësor, a është bërë një plan i mirëfillt për mirëmbajtje të këti parkingu, a e dim sa e ka koston një mirëmbajtje e parkimit nëntokësor ?

Aty duhet me pas dhe klimatizim dhe ajrosje dhe duhet punëtorë me e mirëmbajtë këtë dhe ne si komunë e Malishevës nuk mundemi me ja dalë, sepse është kosto e latë. Pjesa e tjetër e rëndësishme është që parku ka disa drunjë që i ka mbi 20 vite, si ka me funksionu kjo është mirë që ne ta shohim. Kur vjen puna te prezantimi është vonë që ne të japid ide dhe mendime. Është mirë që me i shiku disa detaje se a ja vlen me bërë parking nëntokësor apo nuk ja vlenë, me bërë një plan të mirë të fizibilitetit dhe me shiqu se çka na nevojitet më shumë neve si Komunë e Malishevës.

Te pjesa e qytetit Kryetari e ceku një detaj që tha ju kemi dërgu disa shkresa bizneseve të cilat e dimë që ato biznese janë themeluara në vitin 2000-2001, disa kanë fleta poseduese disa nuk kanë dhe disa kanë marrë legalizim janë pjesë dhe hapësira të legalizimit. Nëse ndodh i njëjtë rast si te

Lumi dhe te shetitorja që për shkak të kallzimeve penale ju kanë ndërprë një projekt madhor, nëse ndalen dhe punimet për qendrën e qytetit atëher ku po mbesim ne në një katrahur të madhe. Për këtë arsy që të na jepet një shpjegim më i mirë se si kanë me u zhvillu këto projekte.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Arlind!

**Arlind Morina:** Përvendetje për të gjithë!

Buxheti është pika më e rëndësishme e jona si anëtarë të kuvendit që do të përballemi këtë vit. Të gjithë kemi mendime të ndryshme dhe në fund duhet të harmonizohum dhe ta votojmë buxhetin. Kjo pikë është një lidhje e ngushtë për asamble dhe qytetarë, ne e dimë që kërkesat nga qytetarët janë shumë të mëdha por kapaciteti i buxhetit është shumë i vogël që të realizohen të gjitha. Kërkoj ndaj kolegëve që të bëhem bashkë dhe ta votojmë buxhetin, në emër të grupit të LDK-së ne e mbështesim projekt-buxhetin dhe me ndryshimet që janë propozuar nga Drejtori për Financa.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Alban!

**Alban Kastrati:** Si Parti Demokratike ne që në fillim kemi thënë që nuk do të jemi opozitë destruktive, por do të jemi opozitë konstruktive dhe do të ju ndihmojmë, do ju japim mbështetje aty ku është interes i qytetarit.

Draft buxhetin të cilin e pamë jo vetëm ne si PDK, por të gjithë si parti opozitare jemi injoruar për arsy se as nuk jemi pytur dhe as nuk keni kërkuar ndonjë mendim nga ne. Te rasti i projekt-buxhetit i keni injoru qytetarët në mënyrë të skajshme, vetëm dy raste po i ceki kur shefi juaj, sepse ju e keni një shef të përbashkët dhe ati i raportoni gjatë fushatës z.Limaj e ka cekur që aty ku ka shkelur këmba e ushtarit duhet të asfaltohet çdo rrugë, është fjala përfshatin Gajrak. Unë po të bëjë thirrje Kryetar dhe ty Nënkyetar pas kësaj seance të shkojmë së bashku dhe ta shikojmë gjendjen në Gajrak. Z.Lima e ka cekë që fshati Damanek është Shqipëria e vogël për arsy se e ka simbolizu flamurin dhe duhet të ketë një përkujdesje të veçantë, shikone a figuron në buxhet fshati Damanek. Kështu që unë kisha kërkuar me qenë pak më serioz mos me injoru. Prapë po them që propozimet tona të i merrni parasysh, sepse nuk janë të këqia por janë të mira.

**Argjend Thaçi:** Alban t'i mundesh me e dhënë mendimin tënd rrëth projekt-buxhetit, por sa i përket shefave secili subjekt politik ka shefin e vetë. Fjalën përfshatin buxhet e ka kërkuar Valon Mazreku.

**Valon Mazreku:** Faleminderit Kryetar përfshatin buxhetin. Në radhë të parë ligji i financave publike e thotë që Buxhetin e propozonë Kryetari i Komunës, dhe e përpilon Kryetari i Komunës me bartësit e tij, ndërsa kuvendi i komunës mund ta votojë si të tillë ose mund ta ndryshojë në bazë të kërkesave që dalin nga anëtarët e kuvendit.

Labinoti tha më herët që me 1 shtator buxheti dorzohet te kuvendi, kuvendi në bazë të projekt-buxhetit Kryetari që e ka propozu i mbanë dëgjimet publike, mirëpo Ministri i Financave të Republikës së Kosovës nuk e ka lëshur qarkoren e dytë buxhetore. Për arsy që neglizhencës atje

nuk kanë mundur të i mbajnë dëgjimet publike pa qarkore të dytë se për të parën janë mbajtur. Vetoni, tha që pas Pavarësisë nuk kemi pasur një rritje kaq të madhe të buxhetit, si vlerë e parasë nominale ki të drejtë, por si vlerë reale e parasë është më e vogël se sa e vitit 2013. Vlera e rritjes së buxhetit e shprehur në përqindje në raport me vitin e kaluar është afër 12%, norma e inflacionit është mbi 20% në qoftëse këto dya i marrim dhe i balancojmë, atëherë vlera reale e buxhetit është më e vogël sesa e vitit 2018-2019.

Kryetar të përgëzoj për buxhetin është një dezinformacion kur thuhet që mbi 20 fshatrat kanë mbet jashtë buxhetit kjo nuk është e vërtetë përveq faktit që buxheti nuk përbëhet vetëm prej njësive kapitale ju keni harruar me cekë këtu që në kuadër të këti buxheti jepen dhe kategorit e tjera ekonomike janë dhe subvencionet, 90.000.00E janë të ndara për bursa të studentëve në kuadër të këti buxheti dhe këta student nuk janë vetëm të Malishevës por janë nga të gjitha fshatrat e komunës së Malishevës. Mbi 200.000.00E euro janë të ndara për bujqësi jo krejt bujqit janë të Malishevës, por janë në gjitha fshatrat e Malishevës, atëherë kjo po del që është dezinformat.

Kryetar unë pashë që keni nda mjete dhe për biznese start up, dhe bizneseve ekzistuese sipas natyrës së veprimtarisë që ato e ushtrojnë është dhe një e mirë e madhe kur në këto ditë të vështira për këto biznese me ju dal në ndihmë me një grand sado simbolik që është. Sa i përket sheshit i nderuar Kryetar, ketu nuk është parku i qytetit por është sheshi i dëshmorëve, ndoshta reagova kur e përmendi Valoni ish Presidentin Rugova, ne mund të ja ndërtojmë një bust Presidentit Rugova ku do qoftë në Malishevë por kjo duhet të mirret iniciativ nga LDK-ja jo nga t'i.

Kryetari në sqarimin e tij e dha shumë të qartë, projekti për sheshin e dëshmorëve është shpallur konkurs, tani është caktu një shumë për projektin ideor, bëhet projekti ideor që do e shohim të gjithë, nuk mundemi ne me i paragjyku se cilat kanë me qenë të hyrat sepse mbrenda ditës Burim munden me qarkullu 1000 vutura. Faza e dytë ne nuk e dimë se sa kushton projekti detal, sepse së pari bëhet projekti ideor vendoset se a po na pëlqen apo jo, pastaj kostoja dhe veprimet për me ardh deri te fotogarfia e projektit ideor është një procedurë tjetër. Pajtjohna kur e ceke që pika më e ulët në aspektin gjeografik është vetë qyteti i Malishevës dhe është problematike trajtimi i ujравe nëntoksore sidomos niveli i ujравe atmosferike, por qysh ka me ndodhë kjo këtë e përcakton vetë projekti detal dhe jo projekti ideor. Kryetar, unë mendoj që ky projekt të kalojë kështu siç është propozu me këto ndryshime që i ka paraqit Drejtori i Financave. Ajo që kërkoj nga ju është që një punë që bëhet në Komunën e Malishevës të bëhet siç duhet dhe mos ta kthejmë më kokën mbrapa pastaj.

**Argjend Thaqi:** Urdhëro, Labinot!

**Labinot Gashi:** Para se të hyjë në temë është mirë që me ju përgjigj disa replikave, si anëtar i LDK-së dhe si asambleist i LDK-së nuk e di që ka kualicion LDK me NISM-ën. Sa i përket temës së buxhetit është jashtë premtimeve elektorale përpos këti projekti madhor që është bërë për plotësimin e nevojave bazike të qytetarëve. Për shembull ujësjellsi, tani po e organizojmë një petition Kryetar me qytetarë të Komunës së Malishevës a jeni për të hequr dorë nga ky projekt

për me e siguru ujin e pijës? Jam I bindur që të gjithë kanë me thënë po. Si projekt është i mire, mirëpo duhet me i shiqu nevojat jetike të qytetarëve, të gjithë fshatrat kemi probleme me kanalizime, kemi mungesë të ujit të pijës kjo është faktike. Nuk pash diqka në projekt buxhet që të rritet kapaciteti në shëndetësi, nuk pash ndonjë projekt që ka në funksion decentralizimit të shërbimeve, ne duhet me mendu që me i ofru shërbime sa më afër qytetarëve. I kam parë disa projekte dhe duhet me e marrë dikush përgjegjësin për qeverisjen e kaluar ku mbi 3.000.000.00E janë shpenzu në buxhet të qytetarëve dhe donacionet për qështjen që me e siguru ujin e pijës në Komunën e Malishevës, por sot banorët problemin më jetik e kanë ujin e pijës.

Sa i përket procedurave të buxhetit nuk thash ne me kalu në vendin e Kryetarit apo Nënkryetarit, sepse ai i ka fituar votat me qenë aty, por nuk bënë në këtë formë me anashkalu kuvendin në këtë kuptim e thash degradim të kuvendit, sepse për mua nuk është e lehtë për me votu ridestinimin e vjetër me i tërhek 70.000.00E sepse dhe mua më kanë votuar dhe munden që të më akuzojnë, por me mirëkuptim që të mos shkojnë mjetet në suficid e kam votuar.

Të gjitha projektet të cilat i kanë adresuar kryetarët e fshatrave, nuk janë në këtë projekt, e ceki Nebihi që ka qenë në projekt i votuar trotuari për gjatë rrugës "Imer Krasniqi" në Kijevë dhe nuk figuron në projekt-buxhet. Fshati është i mbuluar me mbeturina inerte të cilat hudhen.

Çdo projekti është mirë me i shku hap mbas hapi, sepse në fund dikush duhet me dhënë përgjegjësi për projekte të dështuara, është mandati i qeverisjes së njëjtë dikush duhet të marrë përgjegjësi dhe të jep një sqarim për dështimin e këti projekti për ujësjellës dhe të kërkojë falje.

**Argjend Thaçi:** Vetë fakti që tri orë diskutohet për pikën e projekt-buxhetit kuvendi nuk e injoron askënd, tjetra është qështja e padiskutueshme sepse ambiciet e 31 asambleistave nuk mundemi me i plotësu të gjithë njëjtë. Si grup parlamentar keni qenë të ftuar për me i harmonizu qëndrimet për projekt-buxhetin dhe për ti futur projektet të cilat I kemi si LDK, andaj nuk mund të thuash që kuvendi po degradon duke pasur mundësin tri orë debatimi për një pikë të rendit të ditës kjo nuk është serioze. Urdhëro, Nebih Bibaj!

**Nebih Bibaj:** Deshta me u ndërlidh prapë te Kijeva ne në projekt-buxhetin kur Valoni ishte në atë kohë Drejtor i Financave në projekt buxhetin e vitit 2019 kemi pasur dy ekioska, i kemi votuar në projekt-buxhet njëra ka pasur me u vendos në qendrën e Kijevës për nxjerrje të dokumentave, dhe tjetra në oborr të Komunës.

**Vesel Krasniqi:** Në procedur është.

**Nebih Bibaj:** Në rregull vetëm kaq desha të di si informacion, sepse kanë qenë të projektume por qenkan të realizushme.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit Nebih!

I lus asambleistar të futen në sallë të përgaditen për votim. Fjalën e ka Veton Zogaj.

**Veton Zogaj:** Muharremi nuk qenka këtu, sepse deshta me diskutu me ju qështjen e stadiumit Liman Gegaj nëse këto 100.000E janë të parapara për ndërtimin e kësaj tribune në Malishev këtu bie ndesh me ligjin për financa publike, sepse stadiumin tashmë e keni dhënë në shfrytëzim për

15 vite dhe këtë ta kthen si kërkesë Ministria e Administratës. Nuk mundet me investu Komuna para publike në një objekt ku tani më është lëshuar në shfrytëzim.

**Muharrem Morina:** Ajo është një kontrat publike në realizim e sipër dhe kontrata nuk është nënshkruar ende, komuna ka të drejt me investu, sepse është vetëm në shfrytëzim.

**Argjend Thaqi:** E hedhim në votim së pari propozimin e Valon Krasniqit. Sallën e lëshojnë grupi i PDK-së, nga grupi LDK- Labinot Gashi dhe Adile Hoxha, VV-Veton Zogaj dhe Arbnore Hoti. Aktualisht të pranishëm në sallë jemi 17 anëtarë që do të thotë kemi korum dhe vazhdojmë punimet. I hedhim në votim propozimet e Valon Krasniqit. Propozimi 1- Dragobil parkingu I jashtëm I shkollës “Emin Duraku”. Propozimi 2-Balincë ndriqimi publik rruga “Martirët e Kelmendëve”. Propozimi 3-Bardhë vendosja e gypave dhe rregullimi i rrjetit të kanalizimeve dhe ujrale atmosferike në rrugën “Ahmet Krasniqi” ku si pasojë e ndërhyrjes urgjente në këtë rrugë pas qdo vërvshimi bllokohet rruga. Asfaltimi i rrugës 750mdhe ndriqimi publik në rrugën Ahmet Krasniqi. Urdhëro Nënkyetar!

**Vesel Krasniqi:** Te shkolla në Dragobil kemi bërë marrveshje dhe kontrat sot nënshkruhet që përfshihet dhe parkingu dhe të sigurojë që ajo përfundohet këtë nuk kemi pse ta vendosim në votim. Dhe qështja e ndriqimit rregullohet, sepse është e kontraktuar.

**Valon Krasniqi:** Të gjitha kërkesat të cilat i ngrita për shkak të dëgjimit publik është e parapamë një kod buxhetor për këto kërkesa po shpresoj që kanë me gjetë mirëkuptim, pra po mbetet vetëm kërkesa për 750m rrugë të cilat i kam cekë se cilat rrugica janë.

**Argjend Thaqi:** E hedhim në votim propozimin e Valonit. Kush është për?

Për- 1

Kundër- 13

Abstenim- 3

Pra nuk kalon ky propozim.

Anëtarë nga Lista Guxo-Valon Krasniqi lëshon sallën.

E hedhim në votim projekt-buxhetin e propozuar nga Kryetari së bashku me ndryshimet e propozuara nga Drejtori për buxhet dhe financa. Kush është për?

Në mënyr unanime aprovohet projekt-buxheti për vitin 2023-2025.

Urime Kryetar, urime të gjithve! I ftojë të gjithë anëtarët të ulen dhe të vazhdojmë dhe disa pika që i kemi. Anëtarët të cilët lëshuan sallën ju bashkohen mbledhjes së kuvendit.

Pika e radhës është shqyrtimi dhe miratimi I kërkesës nr.02/252 datë: 23.05.2022 të parashtruar nga Besnik Bytyqi për lejimin apo kufizimin me rrethoja në fshatin Shkozë. Kjo kërkesë është e kaluar në KPF dhe pas kërkesës tonë në gjeodezi, kadastër dhe pronë ku e ka pranu kërkesën përmes postës me datën 08.06.2022 nga komiteti për politik dhe financa me anë të së cilës është kërkuar dalje në teren për rinevimin dhe evidentimin e murit nën gasjen kadastrale të 72310049-

00450-0 zona kadastrale shkozë komuna Malishevë. Pas daljes në teren dhe levimit gjeodezik konstatojm se në fshatin shkoz përkatsisht rreth varrezave të këti fshati është duke u punuar një muri i cili nuk ka të bëjë me rregullimin e varrezave. Dhe pas verifikimeve dhe shenimeve kadastrale muri është duke u ndërtuar në pjesën e ngazës 450-0 e cila është në gaster në pronsi të komunës së Malishevës. Rregullimi i murit nuk paraqet penges për lëvizjen e lirë në rrugë dhe trotuar andaj sipërfaqja e kërkuar në këtë ngaster është 640m katror. Pra kemi të bëjm me rrithoja të varrezave që kanë kërkuar pëlqimin e kuvendit komunal. Urdhëro Nebih Bibaj

**Nebih Bibaj:** Faleminderit për paraqitjen e kërkësës së qytetarit nga fshati Shkozë. Mua më intereson që në këtë kërkësë të ati qytetari, a ka të bashkangjitur kërkësën e kryesisë së fshatit apo është kërkës e t'i personale, dhe sipas praktikave të kaluara kur është bërë një kërkësë që është në interest të veqantë, përgjegjës në një far forme është kryetari i fshatit dhe kryesia e fshatit. Siç e pash në kuader të kesaj është një kërkësë personale e qytetarit ku nuk ka tëbëjë me kryetarin dhe kryesin e fshatit. Ne duhet të gjurmojmë mirë në atë pjesë për arsyen mos po gabojmë në vendimet tonë që i marrim, ndoshta njëra palë mundet me qenë kundër dhe pala tjetër e cila pretendon me ndërtu murin është pro asaj. Kishte qenë mirë që kjo kërkësë me u kthy mbrapa në KPF-ë që ati qytetari me ju kërkoi lista e nënshkrimeve dhe pëlqimet e qytetarëve të fshatit.

**Argjend Thaçi:** E para investimi është personal dhe e dyta prona në të cilën investohet nuk është private por është proën e Komunës së Malishevës që do të thotë vendos kuvendi komunal për atë pronë. Arlind Morina e ka kërkuar fjalën.

**Arlind Morina:** Sa i përket kësaj kërkëse të parashtruar nga qytetari, ne e mbështesim por e dime që investimi është nga të hyrat vetanake mendojmë që është kërkësë me vend dhe këto problemet që i kanë me kryesin e fshatit nuk mendojmë që ne duhet ti japim zgjidhje, problemet duhet ti zgjidhin ata në lokalitetin e tyre. Une jom pro e kësaj kërkëse.

**Argjend Thaçi :**Urdhëro, Halil!

**Halil Morina:** Sa i përket kësaj pike më ka ikur si pikë e rendit të ditës, nëse ai ka vendosur që me buxhet të tij personal të rrithojë varrezat e fshatit, përsë me qenë në kundërshtim kryesia e fshatit. Është krejtësisht legjitim që kryesia e fshatit me qenë të shqetësuar për këtë qështje por është dashur që kryesia e fshatit me pas një shpjegim se përsë është kundër një investimi që në shikim të parë nuk duket që ka ndonjë gjë që është problematike.

Nëse nuk është qështje urgjente unë kisha thënë me e shty dhe me i sjellë nënshkrimet e banorëve të fshatit dhe nëse banorët e fshatit të Shkozës janë pro e kësaj, atëherë ne vetëm mundemi me i duartrokit këti veprimi human.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro,Alban!

**Alban Kastrati:** Ne i kuptojmë interesat dhe kërkësat e qytetarëve, por nganjëher nuk mundemi me ju ik disa hapave procedural. Së pari ne kemi kërkesa të ndryshme për ambicie personale apo interes që kanë, për këtë arsyë është e rregulluar dhe me statut të komunës që ne i kemi në

secalin fshat. Kryetarët e fshatrave për këtë arsy që me i rregullu qështjet dhe me ardhë në mënyrë të rregulluar. Është mirë që kjo kërkesë me u rikthy mbrapa dhe me i sjellë nënshkrimet dhe atëherë e votojmë.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Veton!

**Veton Zogaj:** Kjo kërkesë në KPF-ë, ne e kemi dërguar në gjeodezi që të shkohet dhe të shikohet gjendjen në teren, dhe ka konstatuar saktë që muri mbrojtës është për rrëthimin e varrezave dhe jo për ndonjë gjë tjetër. Unë po e ndaj mendimin së bashku me kolegët e tjerë se ndoshta është më mirë me e rikthy dhe njëherë te fshati me shiqu se a ka pajtueshmëri nga kryesia e fshatit dhe kjo kërkesë të vjen direkt në kuvend. Në anën tjetër po i shoh që disa fshatra që po i bëjnë disa investime private për ndërtimin e shtëpive për nevoja të komunitetit, një prej tyre ishte në Tërpez në lagjen “Lahaj” nuk e di a kanë marrë leje, sepse nuk e di që ju kemi dhënë ne leje atyre.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Labinot!

**Labinot Gashi:** Sa i përket kësaj kërkesë po pajtohna me para folësit, ne nuk mundemi me e shti dikan në konflik me ose pa vetëdije. Procedura kërkon që kërkesat në emër të fshatit të bëhen nga Kryetari I fshatit. Pra është mirë që me e marrë pëlqimin e fshatit dhe neve nuk na mbetet gjë tjetër vetëm ta votojmë, sepse është gjest human. Ne me vendime tona nuk është mirë që të nxitojmë nuk është qështje urgjente le të shtyhet dhe të plotësohet kërkesa pastaj të sillet prapë në kuvend.

**Argjend Thaçi:** Unë propozojë që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet dhe t'i rikthehet qytetarit për një nënshkrim apo peticion nga qytetarët e ati fshatit. Urdhëro, Halil!

**Halil Morina:** Në seancën tjetër qytetari e sjell peticionin e nënshkrimeve të banorëve të fshatit, kryesia e fshatit mundet me e sjellë një shkresë se përsë është kundër. Ti marrim opinionet e të dyshpalëve dhe pastaj të vendosim.

**Argjend Thaçi:** Kush është për që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancen e radhës me propozimet?

Me 25 vota për, 1-kundër, 1-abstenim shtyhet kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e radhës është shqyrtimi i kërkesës nr. 11/651 datë: 13.09.2022 e parashtruar nga Drejtoria për Arsim dhe Edukim për komisionin përzgjedhës për shqyrtimin e konkursit për zgjedhjen e Drejtorit dhe Zëvendës Drejtorit në institucionet arsimore, që janë në varësi të komunës sipas konkursit nr.11/1418 datë: 18.08.2022, nr.11/1419 datë: 12.08.2022. Drejtoresha e arsimit e ka fjalën!

**Arbëresha Krasniqi:** Përvshëndetje për të gjithë!

Ne e kemi kërkesen dhe kjo kërkesë shkon te kryetari i komunës që të kalojë në KPF dhe i njëjti ta kalojë që ta merr vlerësimin e asambles komunale në Malishevë. Emrat janë të njëjtë sikur qysh kanë qenë në komisionin e kaluar është magjistër Enver Mazreku, një anëtar që duhet të jetë nga

Drejtoria e Arsimit dhe duhet të jetë me kualifikim të masterit. Dhe është një prej drejtorëve të komunës së Malishevës i cili ka qenë dhe në komisionin e kaluar dhe propozojmë me qenë prap është Agroni. Enveri është Master me kualifikim i plotëson të gjitha kushtet dhe ka bërë një punë të mirë në Komisionin e kaluar, gjithashtu dhe Agroni është një Drejtor dhe mësues i mirë i lokalitetit dhe njëkohësisht i këshillave të prindërve në shkolla. Kështu që është propozim i imi personalisht që ta votoni dhe ta mbështetni këtë komision dhe këta dy emra. Një kohësisht një prej anëtarëve të tjerë i cili do ta përbëjë këtë komision është përfaqësues nga Ministria e Arsimit, Shkences dhe Teknologjis. Ju kërkoj besimin tuaj me qëllim që të vazhdoj punën për reduktimin e 13 Drejtorëve të tjerë të cilët tashmë konkursi i tyre është i mbyllur.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Halil!

**Halil Morina:** Meqë kjo është një obligim ligor për me i hapë rrugë zgjedhjes së menaxherëve të institucioneve shkollore dhe meqë këta të propozuarit i plotësojnë kriteret e parapara atëherë ne si grup i Nismës votojmë pro këti komisioni.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Nebih!

**Nebih Bibaj:** Ne siç i kemi pasur dyshimet dhe në atë pjesën e kaluar që ky komision nuk do ta kryej punën mirë jo që nuk janë njerëz dhe burra të mirë dhe profesional, por janë të ndikuar dhe siq e dimë dhe konkursi i kaluar ka shkuar me disa të gjetura dhe ato të gjetura së shpejti do të bëhen publike në zgjedhjen e Drejtorëve të cilët seriozisht kanë pasur probleme gjatë rekurutimit. Tashmë janë në fazë ku shumë shpejt do të paraqitet përfundimi i pozitave të cilat janë zgjedhur Drejtorët. Nëse veq dëshmohet që ka pasur shkelje të procedurave në zgjedhjen e Drejtorëve të kaluar, unë urojë që procesi i zgjedhjes së Drejtorëve të bëhet siq duhet sepse është shtylla e një shkolle dhe nuk ka të bëjë që ta dërgoni një shok apo një shoqe, sepse nuk e kemi gjendjen e mirë në arsim. Ne jemi kundër këti Komisioni kemi qenë dhe më herët kundër dhe jemi prap kundër, nuk jemi kundër këtyre përsoneve por jemi kundër kësaj logjike të formuar që me qenë vetëm aktivist i partis tonë në kuadër të komisioneve dhe në ato komisione po lindin probleme ku njerëzve kanë me ju shkaktuar probleme në të ardhmen. Ne si grup parlamentar jemi kundër i këti komisioni.Urdhëro, Veton!

**Veton Zogaj:** Për këtë kërkesë të Drejtoris së Arsimit dhe në KPF ju kam dhënë vërejtjet e mia, uroj që gjatë diskutimit të mos keqpërdoret fjalimi im për emrat konkret të cilët i përmendi, sepse kam respekt dhe për Enverin dhe për Agronin, nuk ja kontestoj aspak profesionalizmin në fushën e tyre përkatëse. Mirëpo vërejtja ime konkrete herën e kaluar kur janë propozuar këta dy emra dhe tash vërejtja ime është përfaktin që këta nuk po munden me i ik petkut partiak në punën e tyre si komision. Është shembulli kur janë zgjedhur herën e kaluar drejtorët ku shumë pak prej tyre e kanë merituar mandatin shtes që janë drejtorë. Dhe këta të dy kanë qenë në komision dhe ai personi tjetër i cili e kanë zgjedhur ministria dhe duke qenë në këto rrëthana dhe këta kanë dëshmu që nuk po munden me dal përftej partis po përfundojnë siç po i thotë partia. Unë jam kundër të dyve dhe në anën tjetër Drejtoreshë e dua një sqarim nga t'i përsë nuk ka një komision

për ankesa për konkurentët potencial, disa ma kanë konfirmu që pasi që nuk janë zgjedhur drejtorë nuk kanë pasur se ku të ankohen, sepse nuk ka një komision për ankesa.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Labinot!

**Labinot Gashi:** Sa i përket kësaj pike e thanë dhe parafolësit që shkollat janë në gjendje jo të mirë, përfaktin se 3 vite e më shumë po bëhen që nuk kanë shkolla drejtorë. Është mirë me e pas një qasje më serioze, unë nuk kam asnjë qështje personale me këta të dy. Unë e di që komisioni e ka poentimin dhe në fund kryetari i nënshkruan kontratat. Po binë në ndikim të partis së tyre dhe kandidët nuk i kanë plotësu kriteret përfundojë një herë e mirë pasi që aty kam kundër dhe uroj që procesi i zgjedhjes së drejtorëve të përfundojë një herë e mirë pasi që aty ku nuk ka drejtor shkolle bie dhe niveli i organizimit, cilësia etj. Ju kisha lut me i ik kriterit politik, jepni përparsi kriterit profesional.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Alban!

**Alban Kastrati:** Kur e ka marrë mandatin Drejtoresha që të drejtoj arsimin në Malishevë e kam përgëzu dhe kam prit që me të vërtet të i vendos disa gjëra në binar, të jetë më këmbngulse në vendimet e saj, por ka përfundu sikur drejtorët paraprak. Jam kundër përfundit të arsyen, mënyra sesi kanë ardhur ata si militant partiak është e papranueshme. Dhe e dyta në mënyren se si i kanë përzgjedhë drejtorët e disa shkollave nuk e di mbi qfar vlersimi kanë bërë ata përfundit të ardhë me vazhdu prapë mandatin një drejtori, ku nuk ka tregu përfomancë, nuk ka tregu seriozitet në punë, në menaxhim dhe prapë i vazhdohet. Kështu që përfundit të arsyen jam i zhgënjer dëshirat e kundër.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit Alban, nëse nuk ka përfundit ftoj Drejtoreshën përsqarime!

**Arbëresha Krasniqi:** Alban, ne kur e kemi marrë detyrën, jo vetëm unë si Drejtoreshë por në përgjithësi qeverisja Kastrati në emrin e kësaj të përbashkët NISMA I kemi vërë vetes prioritet, dhe secili digaster i ka prioritetet e veta. Normalisht këto prioritete vijnë në konfirmitet të punëve të mirë që janë bërë përfundit të mandateve që i kemi lënë pas. Qëllimi ka qenë përfundit të ardhë me mirë kur kam ardhur si Drejtoreshë kam pasur mundësin me performancë me i përzgjedh Drejtorët, nuk ja kam lejuar vetes një gjë të till përfundit të arsyen se nuk i kam pasur ende 6 muaj, dhe unë përfundit të ardhë me bërë një përfomancë të drejtorit duhet të kem mandatin 4 vjeçar dhe si rezultat i kësaj jo që nuk kam besuar përfomancës së Ish Drejtorit, por që kam dashur të merrem personalisht me këtë qështje. E kemi liruar situaten që t'i skadoj afati Drejtorave dhe të shpallim konkurs dëshirat e kësaj të marrin përgjigjen e tyre përmes konkursit të shpallur publik. Sa i përket përbërjes së emrave të komisionit ne jemi të obliguar ligjërisht është një emër i cili duhet të vjen nga Drejtoria përfundit, ai emër duhet të i plotësoj kriteret dhe kriteri bazë i ati personaliteti është të ketë kualifikimin Master. Në drejtorin e Arsimit nuk kemi punëtor tjetër që e ka Masterin po të kishte dikush tjetër në këtë rast do të ishte tjetër por nuk ka. Mandej Agroni si përfundit të Drejtorit i shkollës është prej njerëzve shumë kredibil. Enveri dëshirat e Agroni kanë vlerësu në bazë të poetimit. Nëse keni vërejtje specifike përfundit të zgjedhjen e Drejtorëve në konkursin e kaluar, ju kisha

lut të I cekni se cilët janë ata Drejtor që po mendoni që nuk janë kredibil për me menaxhu një institucion shkollorë qoftë të mesëm, qoftë fillor.

Komisioni i ankesave është i formuar në kuadër të komunës. Komuna e Malishevës me kërkesë të Drejtoris për Arsim dhe me vendim të Kryetarit të Komunës është i formuar komisioni për Ankesa. Në këtë komision ka dhe pjesëmarrës nga Drejtoria e Arsimit ku një prej tyre është Salih Berisha. Dhe të gjithë ata që kanë ankesa në përgjedhje apo në procedur ti adresojnë në komisionin për ankesa. Ju kisha lut që ta votoni komisionin, sepse kjo është një process që duhet të përfundojë dhe besoj që ky proces apo kjo procedur do ti ndihmojë shkollave dhe institucioneve tona.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit Drejtoreshë, e hedhim në votim këtë pikë të rendit të ditës Shqyrtimi i kërkesës nr. 11/651 datë 13.09.2022 e parashtruar nga Drejtoria për arsim dhe Edukim, për Komisionin përgjedhës për shqyrtimin e konkursit për zgjedhjen e drejtorit dhe të zëvendësdrejtorit në institucionet arsimore, që janë në vartësi të Komunës, sipas konkursit nr.11/1418 datë:12.08.2022,nr.11/1419 datë: 12.08.2022. Kush është për?

Për:- 14

Kundër : 12

Abstenim: 1

Me 14 vota për, 12 kundër dhe 1 abstenim, aprovohet kjo pikë e rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën e radhës e cila është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/394 datë: 13.09.2022 e parashtruar nga Zyrafete Paqarizi nga fshati Dragobil.Urdhëro, Halil!

**Halil Morina:** Ne fatkeqësish po kemi shumë këso raste me sëmundje të rënda në Komunën e Malishevës. Së pari ne i dëshirojmë shërim sa më të shpejt dhe të plotë kësaj zonjës që e ka bërë kërkesën dhe të gjithë atyre që vujnë nga kjo sëmundje. Kjo është një qështje e ndjeshme unë kisha kërkuar që të del Drejtori i Financave dhe të tregojë mundësit buxhetore se si i ka dhe sa mundet me i nda për këtë punë dhe pastaj ne vendosim.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit Halil, Drejtori e ka fjalën!

**Blerim Thaqi:** Është me të vërtet e dhimbshme dhe nuk mund ta kundërshtoj pasi që nevoja është shumë e madhe për ta ndihmuar, sepse rastet e tillë dëshirojnë shumë ndihmënë stimulimi për plotësimin e nevojave të tyre pësonale sidomos përfundim përfundim, përfundim përfundim. Unë kisha thënë që mundeni me shku deri në shumën 2000.00E dhe atë pa përcaktu kodin se ku duhet të mirren, të specifikoni në ato kode ku dëshironi me i marrë sepse subvencionet në zyrën e Kryetarit kanë përfunduar, subvencionet në pjesen e bujqësisë janë në përfundim, të kulturës janë shpenzu duke i pasur parasysh dhe subvencionimin e klubit me 40.000E. Ka mbetë vetëm pjesa e subvencionimit nga shëndetësia që është një natyr më e përshtatshme por duhet të shqyrtohet mundësia sepse planifikimi i subvencionimit të lehonave caktohet nga vet fakti i lehonave.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Labinot!

**Labinot Gashi:** Drejtor është mirë me ardhë me propozime brenda kapacitetit buxhetor që i ka Komuna. Është mirë me sqaru antartë e KPF-së se në mesin e 6 kërkesave të natyrës së njëjtë, arrin vetëm një në kuvend dhe çka është specifik se të gjitha kërkesat kanë pasur lidhje me komunë, uroj me qenë i fundit. Unë konsideroj që KPF-ja nuk bënë me i trajtu njerzit me standart të dyfysht, të gjitha kërkesat janë adresu në kuvend ato kërkesa është dashur të vijnë në kuvend i kishim ndihmu të gjithëve aq sa kemi mundësi. Po e marr një shembull që është fjala për një puntor të arsimt Zeqir Krasniqi nga Drenoci i cili e ka humbur të pamurit, më janë janë adresu qytetarët që ta ndihmojmë dhe rasti tjetër është në punëtor në Komunë është fjala për Xhevdet Mazrekun kanë qenë 6 kërkesa të natyrës së njëjt që ju kanë adresu kuvendit, pra nuk është mirë me bërë shkelje të tillë sepse dhe ata janë qytetarë të Komunës së Malishevës. Për mua kjo nuk është në rregull të gjitha ata që bëjnë kërkesa janë qytetarë dhe neve nuk na takon me i diferencu në këtë formë. Dhe kërkesa të tillë ju kisha lut me i trajtu me dinjitet ashtu siq e meritojnë.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, drejtor!

**Blerim Thaqi:** Labinot, unë pajtohna me ty se të gjitha këto raste të cilat i përmende janë të natyrës që është dashur të mbështeten përkundër asaj që nuk janë të natyrës së njëjtë. Sëmundjet janë të ndryshme dhe një sygjerim gjithmonë te KPF-ja para se të vijnë në kuvend të merret një informacion se a kemi mundësi buxhetore për me i mbështet sepse me të vërtet janë raste të ndishme.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon!

**Valon Mazreku:** Singersht këto kërkesa janë shumë të ndjeshme dhe nuk është mirë siç tha dhe kolegu që disa me i rekomandu ne kuvend dhe disa jo. Ne shumica këtu që jemi nuk i kemi parë dosjet dhe ato kërkesa dhe nuk mundemi me i paragjyku a kanë qenë kërkesa të natyrës së njëjtë apo jo. Gjithsesi janë qytetarë të barabartë të komunës së Malishevës dhe kjo është parimi, e dyta Drejtori na tregojë për mundësit dhe është reale kjo, sepse ne kemi shpërnda mjete këtu për këto kategori. Unë kisha propozu një vlerë e di që ndoshta është e mangët në raport me nevojën që e ka personi i cili e ka bërë kërkesën, mirëpo ti ndajmë 2000E ne nuk po e specifikojmë nga ky program ose programi tjetër, mirëpo aty ku ka mjete nga kategoria e subvencioneve ta plotësoni këtë kërkesë.

**Argjend Thaçi:** Halili mirë e potencoq që mos të bëjmë shou me këtë kërkes por të dalim te gjërat konkrete, ne të gjitha kërkesat që i kemi pasur si KPF i kemi rekomandu zyrës së Kryetarit me qenë me rekomandim të Drejtoris për Buxhet dhe Financa dhe pse ne nuk dojmë që kërkesa të pa numërt me i sjell këtu dhe mos realizimi i mjeteve mos me i ndodhë. Pra ne jemi shku me rekomandim, ato kërkesa nuk janë refuzu, kryetari e ka një komision që dhuron ndihma momentale mirëpo dihet që Kuvendi nuk është fond i sigurimeve shëndetësore, disa kërkesa më të ndjeshmë më specifike siq i kemi nda dhe në seancat e kaluara.Urdhëro, Veton!

**Veton Zogaj:** Meqenëse jam anëtar i të KPF-së dhe u lakuam gjithë ne si anëtar, çdo herë që kem kërkesa të tillë e pyes Drejtorin Blerim se a kemi buxhet për mbulimin e këtyre shpenzimeve për këto kategori. Ajo që është mangësi e jona në KPF-ë është, sepse nuk kemi profesionist shëndetësor dhe mundohemi me i trajtu kërkesat mbi bazën e natyrës të sëmundjës

që e kanë. Herën tjetër nëse pajtohen dhe anëtarët e tjerë të KPF-së që secila kërkes që vjen me e sjell në kuvend, për ne nuk do të ishte fare pengesë.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit Veton, Alban Kastrati e ka fjalën!

**Alban Kastrati:** Këto kërkesa janë shumë të dhimbshme, dhe emocionuse sepse na bënë me u ndi keq dhe pajtohum me parafolësit që duhet pak me u konsultu me Drejtorin e financave dhe me e pa mundësin se a mundemi me i ndihmu tani me rekomandu në Kuvend. Rastit në fjalë një dozë po i kushtojke 6000E dhe unë i kisha propozu që së paku 50% ta përkrahim pra 3000E.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Rukije!

**Rukije Bytyqi:** I nderuari Labinot ne të gjitha qështjet i trajtojmë njëjtë, por te analizimi i këtyre dosjeve e shikojmë dhe mos hënë gjithashtu këto raste nënët janë shtylla kryesore e familjes, duke parë që gati çdo familje ka kësi raste kaq të ndijshme ne kemi parë që zonja në fjalë të cilën e këmi sjellë në kuvend kërkesën e saj, e kemi parë që ka më shumë nevojë nga të gjitha rastet që janë cekë aty. Pa i anashkaluar dhe të tjerët, mirëpo të gjitha sëmundjen janë që presin ka kohë për shërimin e tyre, por sëmundja tjetër siq është rasti i kancerit është që nuk të dhuron kohë. Urojë që zonja në fjalë të shërohet sa më shpejtë.

**Argjend Thaqi:** Urdhëro, Labinot!

**Labinot Gashi:** Unë e di që sëmundjet dallojnë, por të paktën në procedur mos me bërë dallime, sepse minden me thënë këti i ndihmuani dhe mua jo, mundemi me dal keq si kuvend.

**Argjend Thaçi:** E hedhim në votim kërkesës nr.02/394 datë: 13.09.2022 e parashtuar nga Zyrafete Paqarizi nga fshati Dragobil, në ndihmë financiare 2000E. Kush është për? Me vota unanime, aprovohet kjo pikë e rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën e radhës Zëvendësimi i anëtarit të komisionit për Bujqësi. Kush është për që Mërgim Krasniqi të zëvendësohet me Valon Krasniqin?

Me vota unanime aprovohet dhe kjo pikë e rendit të ditës.

Pika radhës është shfuqizimi i vendimit nr. 02-367 sipas kërkesës së MAPL-së nr.4911/2022 datë: 07.09.2022. Kush është për?

Në mënyr unanimë dhe kjo pikë e rendit të ditës aprovohet.

A keni diqka te pika jashtë rendit të ditës. Nëse nuk ka diskutues, këtë mbledhje e shpalli të mbyllur.

Përfundoi në ora: 16:55.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina



Kryesuesi i Kuvendit

Argjend Thaçi:

